



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 10

2001

Mars

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr.66, datë 15.2.2001	Për një shtesë në vendimin nr. 355, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit".....	311
Vendim i KM nr. 68, datë 15.2.2001	Për miratimin e standarteve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit.....	311
Vendim i KM nr.71, datë 15.2.2001	Për miratimin e pagesave, që kryhen pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.....	317
Vendim i KM nr.75, datë 15.2.2001	Për numrin e punonjësve të institucioneve buxhetore, për vitin 2001.....	320
Vendim i KM nr.100, datë 2.3.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.379, datë 12.6.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr.32, datë 24.3.1978, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.459, datë 15.8.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për prodhimin shpërndarjen dhe përdorimin e energjisë elektrike"”.....	322
Vendim i KM nr.101, datë 2.3.2001	Për privatizimin dhe mbylljen e disa minierave të qymyrgurit, në rrethin e Tiranës.....	323

Vendim i KM nr.107, datë 2.3.2001	Për miratimin e strategjisë kombëtare për fëmijët.....	324
Vendim i KM nr.112, datë 8.3.2001	Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore.....	324
Vendim i KM nr.114, datë 8.3.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.353, datë 7.7.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar””....	325
Vendim i KM nr.116, datë 8.3.2001	Për një dhënie fondi ndihme disa partive të reja.....	325
Vendim i KM nr.117, datë 8.3.2001	Për një shtesë fondi komunës Poroçan, në rrethin e Gramshit.....	326
Vendim i KM nr.118, datë 8.3.2001	Për caktimin e kuotës së trajtimit të dhuruesve të gjakut.	327
Vendim i KM nr.119, datë 8.3.2001	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për projektin “Minimumi jetik, zyrtar”.....	327
Vendim i KM nr.120, datë 8.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore, suplementare, të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit””.....	331
Vendim i KM nr.121, datë 15.3.2001	Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar.....	332
Vendim i KM nr.122, datë 15.3.2001	Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.....	334
Vendim i KM nr.124, datë 15.3.2001	Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, që ndodhet në Rrjetin Kombëtar të Arkivave.....	337
Udhëzim i MPP nr.2, datë 26.1.2001	Për zbatimin e ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore” dhe të vendimit nr. 63, datë 26.1.2001, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e kërkimit, të shqyrtimit dhe të dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e rezervave ujore”.....	338
Udhëzim i MPL nr. 3, date 28.02.2001	Për përdorimin efektiv të fondeve për investimet publike për vitin 2001.....	346

Vendim i GJK nr.5, datë 7.2.2001	Me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.371, datë 27.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.....	351
Vendim i GJK nr.9, datë 22.2.2001	Me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve penale nr.97, datë 2.4.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.670, datë 1.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.....	356
	Për dhënie licence.....	358
Vendim i GJRGJ Shkodër nr.788, datë 17.8.2000	Për shpallje të zhdukur të Dashamir Muçllarit.....	361
Vendim i GJRGJ Shkodër nr.71, datë 15.1.2000	Për shpallje të zhdukur të Mehmet Recaj.....	361
GJRGJ Dibër	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Urim Topuzit.....	361
GJRGJ Fier	Kërkesë për shpallje të vdekur të Magdalena Tomës.....	361
GJRGJ Kolonjë	Kërkesë për shpallje të vdekur të Rakip Shipes.....	362

VENDIM
Nr. 66, datë 15.2.2001

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 355, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE
DHE TË SHËRBIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 355, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, në pikën 4, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

- "- Kryesia e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.
 - Kryetarët e dhomave të avokatisë në rrethe."
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 68, datë 15.2.2001

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE TË PROJEKTIMIT
DHE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e standardeve në punimet e ndërtimit, që kanë të bëjnë me sigurimin e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Miratimin e kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA NR 1
LISTA E STANDARDEVE

1. SSH	543 : 1987	Tulla silikate të plota
2. SSH	551 : 1987	Gurë gëlqerorë për muraturë
3. SSH	2505 : 1987	Tulla të plota prej argjile
4. SSH	2572 : 1987	Tulla argjili me veshë dhe tulla dekorative
5. SSH	511 : 1987	Çimento
6. SSH	562 : 1987	Betone hidroteknike. Klasifikime dhe kërkesat cilësore
7. SSH	564 : 1987	Betone të zakonshëm. Kërkesat cilësore për materialet përbërëse
8. SSH	571 : 1987	Betone të zakonshëm. Klasifikime dhe kërkesat cilësore
9. SSH	104 : 1988	Panele të ndryshme betonarmeje, plinta betoni e b/arme për bujqësinë
10. SSH	199 : 1988	Traversa dekovili të paranderura betonarme
11. SSH	200 : 1988	Shtylla e kapele të zakonshme e të paranderura betonarme
12. SSH	507 : 1988	Bloqe betoni
13. SSH	535 : 1988	Penale betonarme me vrima të zakonshme
14. SSH	545 : 1988	Shtylla të centrifuguara betonarme
15. SSH	552 : 1988	Panele të mëdha të parapërgatitura betonarme për mure, dysheme dhe elementë të tjerë
16. SSH	553 : 1988	Prodhime të parapërgatitura betoni e betonarmeje të zakonshme e të paranderura. Kërkesat cilësore
17. SSH	558 : 1988	Panele betonarme govate për mbulimin e ndërtesave industriale
18. SSH	2765 : 1998	Kolona të parapërgatitura betonarme
19. SSH	2766 : 1988	Trarë betonarme të parapërgatitura
20. SSH	2769 : 1988	Pilota të parapërgatitura betonarme
21. SSH	2851 : 1988	Soleta të paranderura betonarme
22. SSH	2852 : 1998	Kapriata të paranderura betonarme
23. SSH	2853 : 1988	Arkitrarë betonarme të parapërgatitura me dhe pa ngarkesë
24. SSH	2859 : 1988	Panele të paranderura betonarme me 2 dhe 3 vrima
25. SSH	3156 : 1988	Trarë me qeramikë të armuar
26. SSH	ENV 206 : 1997	Betoni, vetitë, prodhimi, përpunimi dhe kriteret e përshtatshmërisë
27. SSH	501 : 1987	Çimento: Karakteristikat

LIDHJA NR. 2
KUSHTET TEKNIKE TË ZBATIMIT

1. Zbatim punimesh. Kushte të përgjithshme për zbatimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtim – montimit (KTZ 01-80).

2. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të gërmimit dhe të mbushjes në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 2-78).

3. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të themeleve për makineritë (KTZ 3-76).
4. Zbatim punimesh themeli e muri me gur natyror. Të dhëna ndërtimi (KTZ 4-79).
5. Zbatim punimesh themele. Mure me tulla. Të dhëna ndërtimi (KTZ 5-79).
6. Zbatim punimesh suvatimi në ndërtesat (KTZ 6-79).
7. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni dhe beton/armeje në veprat hidroteknike (KTZ 7-81).
8. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për veshje të faqeve të mureve të brendshme e të jashtme në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 8-79).
9. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të hidroizolimit në ndërtesat qytetare, industriale e bujqësore (KTZ 9-79).
10. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni dhe betonarmeje në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore. Strukturat monolite (KTZ 10/1-78).
11. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni e betonarmeje në veprat industriale qytetare e bujqësore. Struktura të papërgatitura (KTZ 10/2-78).
12. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve prej betoni dhe betonarmeje në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore. Struktura të paranderura (KTZ 10/3-78).
13. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve prej betoni dhe betonarmeje në ndërtesat industriale qytetare dhe bujqësore. Ndërtimi i oxhaqeve të lartë prej betonarmeje dhe me tulla (KTZ 10/4-80).
14. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të ndërtimit të ndërtesave me panele të mëdha prej betoni të armuar (KTZ 10-79).
15. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me materiale zjarrduruese dhe termoizoluese. Betone zjarrduruese me lidhje çimentoje (KTZ 12/1-79).
16. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me material zjarrdurues dhe termoizolues. Këmisha termoizoluese dhe zjarrduruese në furrat e industrisë së naftës (KTZ 12/2-79).
17. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me material zjarrdurues dhe termoizolues, muraturë me tullë zjarrduruese e izoluese në furrat e industrisë së përpunimit të naftës (KTZ 12/3-78).
18. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për ndërtimin e rezervuarëve metalik mbitokësorë naftëmbajtës (KTZ 13-80).
19. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për termoizolim e tubacioneve, paisjeve dhe rezervuarëve (KTZ 14-79).
20. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për mbrojtjen e strukturave në mjedise grryese acide (KTZ 15-79). Rishikimi : 1985
21. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të karpentjerisë dhe zdrukthtarisë me dru në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 16-79). Rishikimi : 1985
22. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për ndërtimin e dyshemeve në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 17-79). Rishikuar : 1985
23. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për mbulimin e çative në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 18-79). Rishikimi : 1985
24. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e skelave me tuba çeliku (KTZ 19-79). Rishikimi : 1985
25. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të bojatisjes dhe të vendosjes së xhamave në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 20-79)
26. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të konstruksioneve metalike (KTZ 21-80).
27. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me pilota (KTZ 22-81).
28. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve e punimeve detare, thellim portesh (KTZ 23-81).
29. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve sanitare, teknike në ndërtesat e banimit, shoqëroro-kulturore dhe mjedis ndihmëse të veprave industriale (KTZ 25-81).
30. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për përfundimin e rrjetit të jashtëm të ujësjellësve dhe kanalizimeve (KTZ 28-81).

31. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të instalimit të ngrohjes në mjediset e banimit shoqëro-kulturore dhe të prodhimit (KTZ 27-81).
32. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike, pjesa e përgjithshme (KTZ 28-80).
33. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike me përcjellës (KTZ 29-80).
34. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike. Montimi i linjave kabllore (KTZ 30-80).
35. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike, instalimet e tokëzimit (KTZ 31-80).
36. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike (KTZ 32-80).
37. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të ndërtim-montimit në linjat ajrore të tensionit të lartë (KTZ 33-81).
38. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve, të çimentimit në formacionet shkëmbore (KTZ 34-81).
39. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të veprave në rrugët hekurudhore (KTZ 36-81).
40. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për mbushje dhe gjermim në hekurudha (KTZ 37-81).
41. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të shtresave në rrugë, autostradë, etj. (KTZ 38-81).
42. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me pilota UKS (KTZ 39-81).
43. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me shpërthim me mina elektrike (KTZ 40-81).
44. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me shpërthime elektrike (KTZ 41-82).
45. Kushte teknike të zbatimit të punimeve të montimit të pajisjeve elektrike në nënstacionet elektrike (KTZ 42-82).
46. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve të furrave të pjekjes së tullave (KTZ 43-82).
47. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve të kullave të ftohjes prej betonarmeje në formë hiperbolike (KTZ 44-82).
48. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve për ndërtimin e silloseve beton arme (KTZ 45-84).
49. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve për ndërtimin e digave të mesme prej dheu me lartësi deri 50 m (KTZ 46-84).
50. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve për ndërtimin e tuneleve (KTZ 47-84).
51. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve të termoizolimit të taracave me skorjet e Selenicës (Vlorë) dhe banesa, vepra shoqërore dhe industriale (KTZ 48-88).
52. Kushte teknike të shmangieve të lejuara në ndërtim-montim (KTZ 49-89).
53. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e konstruksioneve dhe tubave prej viniplasti (PVC) (KTZ 201-80).
54. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e konstruksioneve dhe tubave prej alumini e lidhjeve të tij (KTZ 202-80).
55. Zbatimi i punimeve për montimin e pompave stacionare dhe ventilatorëve centrifugalë të veprave industriale (KTZ 203-80).
56. Zbatimi dhe marrja në dorëzim për montimin e pajisjeve hidraulike statike (KTZ 204-80).
57. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e elevatorëve dhe të transportjerëve në veprat industriale (KTZ 205-80).
58. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e çeliqueve inoksidabël në veprat industriale (KTZ 206-80).
59. Zbatimi dhe marrja në dorëzim i punimeve për montimin e sistemeve të ventilimit (KTZ 207-80)

60. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të ashensorëve dhe ngritësve të ngarkesave (KTZ 208-80).

61. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të linjave të tubacioneve teknologjike dhe të avullit dhe të ujit të nxehtë mbitokësor (KTZ 209-80).

62. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e kompresorëve me piston horizontal në veprat industriale (KTZ 210-80).

63. Zbatimi i punimeve për përdorimin e mekanizmave dhe pajisjen e ngritjes së ngarkesave (KTZ 211-81)

64. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e tubave dhe të konstruksioneve prej bakri dhe lidhjeve të tij (KTZ 212-80).

65. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e plumbit në veprat industriale (KTZ -81).

66. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e tubacioneve të turbinave të H/C (KTZ 214-81).

67. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit dhe portave të H/C (KTZ 215-81).

68. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e udhëzuesve të portave të H/C (KTZ 216-81).

69. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e rezervuarëve sferikë (metalikë) (KTZ 217-80).

70. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e mullinjve cilindrikë të bluarjes (KTZ 218-81).

71. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e furrave rrotulluese horizontale për pjekje klinkeri (KTZ 219-81).

72. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e vinçit me peshëngritje 6 ton (KTZ 220-81).

73. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të vinçit urë (KTZ 221-81).

74. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të vinçit Cjap (KTZ 222-81).

75. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të shnekëve (KTZ 224-81).

76. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të makinave metal punuese (KTZ 228-81).

77. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e tubacioneve të gazsjellësit (KTZ 235-81).

78. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të vinçave shtyllë (direk). (KTZ 238-81).

KUSHTET TEKNIKE TË PROJEKTIMIT

1. Kriteria projektimi për veprat e industrisë mekanike, të pasurimit të mineraleve, depove e stallave (KTP 1-78).

2. Kriteria projektimi e ndërtimi në zona sizmike (KTP 2-78).

3. Kriteria projektimi. Klasifikimi i veprave ekonomike e shoqërore (KTP 3-78).

4. Kriteria projektimi. Kategorizimi dhe kalasifikimi i veprave hidroteknike (KTP 4-78).

5. Kriteria projektimi. Klasifikimi i dherave joshkëmbore që shërbejnë si bazament për veprat inxhinierike (KTP 5-78).

6. Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesave në objektet shoqërore ekonomike (KTP 6-78).

7. Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesës së erës (KTP 7-78).

8. Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesës së borës (KTP 8-78).

9. Kriteria projektimi. Llogaritja e mureve dhe themeleve me teorinë e gjendjes kufitare. (KTP 9-78).

10. Kriteria projektimi. Llogaritja e konstruksioneve prej çeliku (KTP 10-78).

11. Kriteria projektimi. Llogaritja e rrjetit të jashtëm të furnizimit me ujë (KTP 11-78).

12. Kriteria projektimi. Llogaritja e rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimet (KTP 12-78).
13. Kriteria projektimi të sistemeve të ngrohjes qendrore dhe të ajrimit (KTP 13-78).
14. Kriteria projektimi. Instalimet e ndriçimit në veprat ekonomiko-shoqërore (KTP 14-78).
15. Kriteria projektimi. Instalimet elektrike në mjediset me rrezik zjarri (KTP 15-78).
16. Kriteria projektimi. Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike (KTP 16-78).
17. Kriteria projektimi. Mbrojtja reale dhe automatike. (KTP 17-78).
18. Kriteria projektimi të linjave ajrore të tensionit të lartë (KTP 18-78).
19. Kriteria projektimi të impiantit shpërndarës dhe të nënstacioneve me tension mbi 1000V (KTP 19-78).
20. Kriteria projektimi të hekurudhave (KTP 20-78).
21. Kriteria projektimi për urat e tominat prej betoni e beton armeje në hekurudhat (KTP 21-78).
22. Kriteria projektimi për rrugët automobilistike (KTP 22-78).
23. Kriteria projektimi për urat e tominat prej betoni dhe beton armeje në rrugët automobilistike (KTP 23-78).
24. Kriteria projektimi. Tunelet hidroteknike (KTP 24-78).
25. Udhëzime teknike projektimi. Mbi përmbajtjen e projekteve sipas fazave të projektimit të veprave të ndërtimit.
26. Simbolet në llogaritjen e konstruksioneve të ndërtimit.
27. Standardet e "Paraqitjes grafike të projekteve dhe simbolet në Vizatimet e Ndërtimit".
28. Metodika e përcaktimit të përshkueshmërisë së formacioneve me metoda direkte në terren.
29. Metodika e përcaktimit soliditetit të dherave në shtupje njëboshtore.
30. Udhëzuesi i studimeve gjeologo-inxhinierike për ura, viadukte mbikalime e nënkalime hekurudhore.
31. Hidroizolimi në banesa, objekte social-kulturore dhe ekonomike.
32. Hidroizolimi në veprat e artit rrugor, hekurudhore dhe hidrocentrale.
33. Klasifikimi i veprave dhe ndërtesave ekonomike dhe shoqërore.
34. Veprat ekonomike dhe shoqërore. Kriteret bazë llogaritëse.
35. Llogaritja e konstruksioneve prej guri të veprave shoqërore dhe ekonomike me teorinë e gjendjes kufitare.
36. Mbi ngarkesat dhe veprimet në rrugët automobilistike.
37. Mbistruktura dhe nënstruktura prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat e artit rrugor dhe hekurudhore (përfshirë dhe çernierat).
38. Tunelet hidroteknike.
39. Konstruksione prej betoni dhe betoni të armuar në veprat hidroteknike me teorinë e gjendjes kufitare.
40. Vlerësimi i agresivitetit të ujit natyror, nëntokësor dhe sipërfaqësor.
41. Veprat hidroteknike në lumenj. Kriteret themelore të projektimit.
42. Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat ekonomike dhe shoqërore me teorinë e gjendjes kufitare.
43. Llogaritja e konstruksioneve b/arme të paranderur në veprat ekonomike dhe shoqërore.
44. Studimi gjeologo-inxhinierik për projektimin e veprave hidroenergjitike.
45. Studimet gjeologo-inxhinierike për projektimin e objekteve nëntokësore (të tuneleve).
46. Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat ekonomike dhe shoqërore me teorinë e gjendjes kufitare.
47. Llogaritja e konstruksioneve prej guri të veprave ekonomike e shoqërore me teorinë e gjendjeve kufitare.
48. Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar në veprat hidroteknike me teorinë e gjendjeve kufitare.

49. Projektimi i veprave të artit, rrugore dhe hekurudhore prej betoni dhe beton armeje të zakonshme.
50. Studime gjeologo-inxhinierike për projektimin e veprave shoqërore kulturore.
51. Studime gjeologo-inxhinierike për projektimin e veprave ekonomike.
52. Përcaktimi i vetive fizike të dherave me metoda laboratorike.
53. Përcaktimi i vetive gjeoteknike të dherave presiometër.
54. Llogaritja e konstruksioneve metalike të veprave shoqërore dhe ekonomike me teorinë e gjendjes kufitare.
55. Udhëzues teknik projektimi. Studime gjeologo-inxhinierike të vendburimeve të materialeve rrethanore të ndërtimit për veprat hidroteknike dhe hekurudhore.
56. Kushte teknike projektimi të bazave e themeleve të objekteve inxhinierike me gjendjen kufitare.
1. Kusht teknik projektimi të bazave e themeleve industriale e ekonomiko-shoqërore me gjendjen kufitare.
 2. Kusht teknik studimeve gjeologo-inxhinierike për projektimin e objekteve industriale dhe ekonomiko-shoqërore me gjendjen kufitare.
 3. Kusht teknik i projektimit të bazave e themeleve të thella masive e me pilota me gjendjen kufitare.
 4. Kusht teknik i studimeve gjeologo-inxhinierike për projektimin e bazave e themeleve masive e me pilota të objekteve inxhinierike me gjendjen kufitare.
57. Udhëzues për llogaritjen e oxhaqeve në veprat industriale.
58. Udhëzues për llogaritjen e themeleve nën makineri (Pjesa teorike Vol.1).
59. Udhëzues për llogaritjen e themeleve nën makineri. Shembuj llogaritës.
60. Detyra tip të projektimit në ndërtim për veprat shoqërore dhe banesat.
61. Detyra tip të projektimit në ndërtim për studimet urbanistike.
62. Detyra tip të projektimit për veprat industriale.
63. Detyra tip të projektimit për vepra të industrisë së material ndërtimit.
64. Detyra tip të projektimit për H/C, tunele dhe vepra detare.
65. Detyra tip të projektimit për veprat hekurudhore, rrugore dhe urat.

VENDIM

Nr. 71, datë 15.2.2001

PËR MIRATIMIN E PAGESAVE, QË KRYHEN PRANË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 91 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesave që kryhen pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Këto pagesa janë subjekt rishikimi në çdo kohë, por jo më vonë se fundi i vitit 2002.
3. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PAGESAT QË KRYHEN PRANË ERT-SË

I. Përpunimi i kërkesave për licencim:

Tipi i licencës	Pagesa	Periodiciteti i pagesës
Licenca individuale të klasit të II-të, me përjashtim të sistemeve private të radiokomunikimit	5.000 lekë	Vetëm një herë
Licenca të përgjithshme	3.000 lekë	Vetëm një herë

II. Dhënie e licencës

Kjo pagesë është e njëjtë me pagesën vjetore dhe kryhet me marrjen e licencës.

III. Pagesë vjetore e licencës

Tipi i licencës	Pagesa e licencës	Periodiciteti i pagesës
Operator publik i telekomunikacioneve		
Licencë		
Operator publik kombëtar	7.000.000 lekë	çdo vit
Operator publik për zonat rurale	20.000 lekë/komunë	çdo vit
Shërbim interneti		
Licencë		
Ofrim shërbimi interneti	30.000 lekë POP	çdo vit
	100.000 lekë ISP lokale	çdo vit
	200.000 lekë ISP rajonale	çdo vit
	300.000 lekë ISP kombëtare	çdo vit
	300.000 lekë Operator Backbone	çdo vit
Regjistrim domain	100 USD	çdo 2 vjet
Shërbim publik radiokomunikimi i lëvizshëm		
Licencë		
Sistem kërkimi personi (Pager)	50.000 lekë për sistem lokal	çdo vit
	100.000 lekë për sistem zonal	çdo vit
	200.000 lekë për sistem kombëtar	çdo vit
Telefoni celulare, radio-fiks	12.500 lekë për çdo kanal pune 25 khz	çdo vit
	100.000 lekë për çdo kanal pune 200 khz	çdo vit
Telefoni satelitore (GMPCS)	2.000 USD	çdo vit
Shërbim aeronautik		
Licencë		
Sisteme tokësore	25.000 lekë	çdo vit
Sisteme në avion	15.000 lekë	çdo vit
Shërbim detar		

Licencë		
Stacion bregdetar	25.000 lekë	çdo vit
Sistem radiokomunikimi në anije	10.000 lekë	çdo vit
Operacione portuale	5.000 lekë	çdo vit
Shërbim satelitor		
Licencë		
Stacion tokësor fiks	200.000 lekë	çdo vit
Sistem satelitor VSAT	20.000 lekë për çdo terminal VSAT	çdo vit
Terminal VSAT (portativ)	5.000 lekë	çdo vit
Stacion tokësor i lëvizshëm (SNG)	1.000 USD për licencë 1 (një) javore	çdo vit
	500 USD për çdo javë vijuese	çdo vit
	2.000 USD për licencë 1 (një) mujore	çdo vit
	5.000 USD për licencë 3 (tre) mujore	çdo vit
Shërbim transmetimi të dhënash		
Licencë		
Transmetim të dhënash	100.000 lekë për sistem lokal	çdo vit
	200.000 lekë për sistem rajonal	çdo vit
	300.000 lekë për sistem kombëtar	çdo vit
Shërbim radioamator		
Certifikatë radioamatori	500 lekë	vetëm 1 herë
Leje transmetimi	200 lekë	çdo 5 vjet
	për radioamatorët e huaj	
	500 lekë leje transmetimi 1 mujore	
	1.000 lekë leje transmetimi 3 mujore	
Shërbimi fiks (radio-rele)		
Licencë		
Lidhje dy drejtimshe (link i plotë), sistem 1+0	30.000 lekë/link për brezin deri 1 Ghz	çdo vit
	50.000 lekë/link për brezin 1 deri 5 Ghz	çdo vit
	80.000 lekë/link për brezin 5 deri 11 Ghz	çdo vit
	120.000 lekë/link për brezin mbi 11 Ghz	çdo vit
	për sisteme 1+1 pagesa e mësipërme rritet 30%	
	për sisteme 2+1 pagesa e mësipërme rritet 40%	
	për sisteme 3+1 pagesa e mësipërme rritet 50%	
	për sisteme një drejtimshe	

	pagesa është sa 1/2 e pagesës për lidhje dy drejtimsh	
Shërbim privat radiokomunikimi i lëvizshëm		
Licencë		
Sistem i lëvizshëm tokësor	5.000 lekë për çdo sistem simpleks	çdo vit
	15.000 lekë për çdo sistem gjysëm duplex	çdo vit
Sistem trunk	15.000 lekë për sistem rajonal	çdo vit
	30.000 lekë për sistem kombëtar	çdo vit
Sistem TETRA	50.000 lekë për sistem rajonal	çdo vit
	100.000 lekë për sistem kombëtar	çdo vit
	sistemi simpleks përfshin një numër të pakufizuar stacione bazë, stacione makine dhe radio portabël	
	sistemi gjysëm duplex përfshin 1 (një) përsëritës dhe numër të pakufizuar stacione bazë, stacione makine dhe radio portabël.	
Shërbime të tjera		
Licencë		
Sistem radio-alarmi	20.000 lekë	çdo vit
Sistem radiokomunikimi në HF	15.000 lekë	çdo vit
Ofrim shërbimesh	10.000 lekë për një qytet/fshat	çdo vit
Telekomunikacioni	20.000 lekë për një rreth	çdo vit
	40.000 lekë për një rajon	çdo vit
	60.000 lekë për gjithë territorin	çdo vit
Instalim, programim, projektim, assemblim , pajisje fundore e sisteme telekomunikacioni		
Licencë		
Instalim, programim, assemblim	10.000 lekë	çdo vit
Projektim, konsulence	5.000 lekë	çdo vit

IV. Pajisje me numra

Kjo pagesë aplikohet vetëm 1 (një) herë si më poshtë:

- a) Kod drejtimi kombëtar- dy shifror50.000 lekë
- tre shifror25.000 lekë
- b) Kod aksesi/prefiksi- tre shifror25.000 lekë
- katër shifror10.000 lekë
- c) Numër i shkurtër- dy shifror50.000 lekë
- tre shifror25.000 lekë

- d) Bllok numrash abonenti- bllok mijësh3.000 lekë
 - bllok dhjetë mijësh6.000 lekë
 V. Miratim tipi
 Kjo pagesë aplikohet vetëm 1 (një) herë si më poshtë:
 Certifikatë Miratim Tipi- 3.000 lekë për subjekte tregtues
 - 100 lekë për subjekte jo tregtues
 - 100 USD për subjekte të huaj

VENDIM
Nr. 75, datë 15.2.2001

**PËR NUMRIN E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE,
 PËR VITIN 2001**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit për vitin 2001” dhe të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i punonjësve në institucionet buxhetore, për vitin 2001 të jetë:
 1 korrik 2001 122 400 punonjës
 1 tetor 2001 122 245 punonjës
 2. Numri i punonjësve, sipas ministrive dhe institucioneve buxhetore, i ndarë në dy periudha, 1 korrik dhe 1 tetor 2001, është sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për çdo ministri dhe institucion buxhetor, për vitin 2001.
 4. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Numri i punonjësve sipas ministrive dhe institucioneve për vitin 2001

Nr.	Emërtimi	1 janar	1 korrik	1 tetor
1.	Presidenca	45	45	45
2.	Kuvendi	302	302	302
3.	Këshilli i Ministrave	226	226	226
4.	Ministria e Ek.Publike dhe Privatizimit	265	265	265
5.	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	1.650	1.600	1580
6.	Ministria e Punëve Publike	3.085	3.050	3000
7.	Ministria e Bashkupimit Ekonomik dhe Tregtisë	115	115	115
8.	Ministria e Transportit	1.472	1.470	1470

9.	Kryeregjistruesi i Pasurisë	242	242	242
10.	Ministria e Financave	435	435	435
11.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	46.000	45.000	45.000
12.	Min.Kulturës Rinisë dhe Sporteve	2.700	2.200	2.150
13.	Ministria e Shëndetësisë	24.000	23.800	23.800
14.	Ministria e Drejtësisë	1.350	1.350	1350
15.	Ministria e Punëve të Jashtme	142	142	142
16.	Ministria e Rendit Publik	14.000	13.300	13.300
17.	Ministria e Mbrojtjes	9.300	9.300	9300
18.	Shërbimi Informativ Kombëtar	1.500	1.500	1500
19.	Drejtoria e Përgjithshme e Radio Televizionit			
20.	Drejtoria e Arkivit të Shtetit	115	115	115
21.	Drejtoria e Rezervës së Shtetit	650	625	600
22.	Akademia e Shkencës	550	550	550
24.	Kontrolli i Lartë i Shtetit	139	139	139
25.	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	1.350	1.300	1300
26.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	70	70	70
27.	Agjencia Kombëtare e Privatizimit	74	70	70
28.	Prokuroria e Përgjithshme	900	900	900
29.	Pushteti Gjyqësor	1.140	1.140	1140
30.	Gjykata Kushtetuese	30	30	30
31.	Agjencia Telegrafike Shqiptare	118	118	118
32.	Ministria e Pushtetit Vendor	9.051	9.000	9000
35.	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1.020	1.020	1020
37.	Drejtoria e Standardeve	25	25	25
39.	Drejtoria e Përgj. e Pyjeve	1.250	1.250	1240
40.	Partitë Politike			
41.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1.300	1.300	1300
50.	Instituti i Statistikës	145	145	145
53.	Komisioni i Letrave me Vlerë			
54.	Enti Kombëtar i Zonave të Lira	7	7	7
55.	Shkolla e Magjistraturës	15	15	15
56.	Fondi i Zhvillimit Shqiptar			
57.	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10	10	10
59.	Instituti i Rehabilitimit të Përndjekurve Politikë	64	64	64
62.	Komiteti Kombëtar i Turizmit	32	32	32
63.	Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	15	15	15
64.	Komiteti Kombëtar i RTV-së			
65.	Avokati i Popullit	47	47	47
66.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	43	43	43
67.	Komisioni i Shërbimit Civil	28	28	28
	Shuma:	125.017	122.400	122.245

VENDIM
Nr. 100, datë 2.3.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.379, DATË 12.6.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.32, DATË 24.3.1978, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.459, DATË 15.8.1994,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRODHIMIN, SHPËRNDARJEN DHE
PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.7962, datë 13.7.1995, “Për energjinë elektrike”, dhe të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.379, datë 12.6.1998, të Këshillit të Ministrave, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

“KESH sh.a., “SESA Shkodër” sh.a., “Elektriku Vlorë” sh.a. dhe “Elektriku” sh.a. Elbasan, t’i drejtohen Entit Rregullator të Energjisë, për të përcaktuar masën e faturimit mujor të energjisë elektrike, për rastet kur përdoruesit familjarë nuk kanë aparate njësjore (matës), të përdorimit të energjisë elektrike ose kur këto aparate i kanë jashtë kushteve teknike të matjes.”.

2. Ngarkohen KESH sh.a., “SESA Shkodër”, Sh.a., “Elektriku Vlorë”, sh.a. dhe “Elektriku” sh.a. Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 101, datë 2.3.2001

PËR PRIVATIZIMIN DHE MBYLLJEN E DISA MINIERAVE TË QYMYRGURIT,
NË RRETHIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të mos konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare, që ushtrojnë veprimtarinë në industrinë nxjerrëse të qymyrgurit dhe t’i nënshtrohen procesit të privatizimit ose likuidimit:

Sh.a. qymyrguri Mushqetarrethi Tiranë

Sh.a. qymyrguri Priskërrethi Tiranë

Sh.a. qymyrguri Kërrabërrethi Tiranë

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda muajit mars 2001, të fillojë procedurat e privatizimit për minierat, që do të privatizohen dhe të hartojë projektet e mbylljes për minierat, që do të mbyllën. Procesi i mbylljes duhet të përfundojë brenda këtij viti.

Gjatë procesit të privatizimit të parashikohet dhe likuidimi i detyrimeve të prapambetura për sigurimet shoqërore.

3. Shpenzimet për mbylljen e minierave të përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2001, për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në zërin “Për konservimin dhe mbylljen e minierave”.

4. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi ose të transferohen në minierat e tjera, të cilat e vazhdojnë veprimtarinë.

5. Punonjësit, të cilët deri më datën 1.1.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së minierave, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të trajtohen për 1 (një) vit, me pagën minimale 7018 lekë në muaj.

6. Kjo periudhë 1 vjeçare të njihet, për efekt pensioni, si vjetërsinë në punë dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

7. Shpenzimet për trajtimin e punonjësve, që humbin vendin e punës, si pasojë e mbylljes së këtyre minierave, që arrijnë shumën 40 000 000 lekë, të përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2001,00. për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Pagesa ndërpritet për punonjësit, që kryejnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit, brenda periudhës së trajtimit me këtë pagesë.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 107, datë 2.3.2001

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR FËMIJËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës “Për të drejtat e fëmijëve””, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare për fëmijët, së bashku me planin e veprimit të Qeverisë për zbatimin e saj, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore dhe Komiteti “Gruaja dhe Familja” për zbatimin e kësaj strategjie.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 112, datë 8.3.2001

PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME
SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “e” të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ruajtjen dhe sigurimin e objekteve shtetërore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, me forcat e Policisë së Shtetit.
 2. Fondi i pagave dhe i shpenzimeve në zbatim të këtij vendimi të mbulohen nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Rendit Publik.
 3. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.651, datë 18.10.1998 “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve shtetërore”, nr.208, datë 29.4.2000 “Për një ndryshim në vendimin nr.651, datë 18.10.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ruajtjen e sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME SHTETËRORE QË MERREN NË RUAJTJE
NGA POLICIA E SHTETIT

1. Godinat e ministrive
2. Godina e Radiotelevizionit Shqiptar
3. Selitë e përfaqësive diplomatike e konsullore
4. Godina e Prokurorisë së Përgjithshme, ushtarake, dhe godinat e prokurorive vendore
5. Godina e Gjykatës së Lartë
6. Godinat e gjykatave të apelit dhe godina e Gjykatës Ushtarake të Apelit
7. Godinat e gjykatave vendore
8. Godinat e prefekturave
9. Banka e Shqipërisë dhe filialet e saj, si dhe objektet “X79” dhe “X88”, Tiranë
10. Godina e Arkivit Qendror Shtetëror
11. Godina e ATSH-së
12. Godina e Institutit të Fizikës Bërthamore
13. Hidrocentrali i Fierzës
14. Hidrocentrali i Komanit

VENDIM
Nr. 114, datë 8.3.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.353, DATË 7.7.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.190, DATË
3.5.1995, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874, DATË
17.11.1994 “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, ndryshuar me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999 dhe me ligjin nr.8664, datë 18.9.2000, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në rreshtin e parë të pikës 9 të vendimit nr.353, datë 7.7.2000, të Këshillit të Ministrave, afati i vënë “brenda muajit shkurt 2001” ndryshon si vijon:

“brenda muajit dhjetor të vitit 2001”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 116, datë 8.3.2001

PËR NJË DHËNIE FONDI NDIHME DISA PARTIVE TË REJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, dhe të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie e një fondi prej 100 mijë lekësh, si ndihmë financiare në çastin e krijimit, për secilën nga këto parti: partisë “Aleanca Nacionale Shqiptare”, “Partisë Shqiptare Ambientaliste” dhe “Partisë së Reformave Demokratike të Shqipërisë”.

2. Efektet financiare përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2001, për partitë e reja.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 117, datë 8.3.2001

PËR NJË SHITESË FONDI KOMUNËS POROÇAN, NË RRETHIN E GRAMSHIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë“, të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001” dhe të vendimit nr.206, datë 26.3.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komunës Poroçan, në rrethin e Gramshit, i shtohet, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, fondi prej 9 488 052 (nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) lekësh, për të ndihmuar 19 familjet, banuese në lagjen Qefaj, të cilave u janë dëmtuar banesat nga rrëshqitja masive e truallit, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Komuna e Poroçanit për shpërndarjen e fondit dhe për të kontrolluar përdorimin e këtij fondi për qëllimin e përmendur në këtë vendim.
4. Ngarkohet prefektura e qarkut të Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

SHTOJCA

Nr. Rend.	Emri, atësia,mbiemri i kryefamiljarit të familjes së dëmtuar	Masa e ndihmës që duhet të përfitojë =F= 0.5 x E x 11070 L/m2 (në lekë)
A	B	F
1.	Qazim Xhelal Qefa	568072
2.	Merushe Vesel Qefa	568072
3.	Nefail Islam Cani	838532
4.	Neim Ismail Qefa	568072
5.	Ismail Nexhip Qefa	568072
6.	Zeço Qamil Qefa	543010
7.	Andon Zeço Qefa	344602
8.	Islam Xhafer Qefa	522125
9.	Sejdin Islam Qefa	271505
10.	Tahir Qamil Qefa	568072
11.	Fatmir Kamber Qefa	532567
12.	Qazim Kamber Qefa	563895
13.	Isa Xhemal Qefa	725753
14.	Xhemal Ali Qefa	229735
15.	Nezir Qamil Qefa	568072
16.	Pëllumb Nezir Qefa	344602
17.	Përparim Nezir Qefa	240177
18.	Hasan Hamit Qefa	568072
19.	Misir Tahir Qefa	355045
	SHUMA	9488052

VENDIM
Nr. 118, datë 8.3.2001

PËR CAKTIMIN E KUOTËS SË TRAJTIMIT TË DHURUESVE TË GJAKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.8032, datë 16.11.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut të produkteve të tij” dhe të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Shëndetësisë të kryejë trajtimin e dhuruesve të gjakut në kuotën e vlerës prej 3 850 (tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh (për njësi prej 450 ml gjak).
 2. Trajtimi ushqimor të kryhet në shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekësh për çdo dhurim gjaku.
 3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2001, i Ministrisë së Shëndetësisë.
 4. Vendimi nr.550, datë 28.8.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për rritjen e kuotës së trajtimit të dhuruesve të gjakut” shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 119, datë 8.3.2001

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2001, TË MINISTRISË SË PUNËS DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE, PËR PROJEKTIN “MINIMUMI JETIK, ZYRTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë“, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektit “Minimumi jetik, zyrtar”.
 2. Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, në buxhetin e vitit 2001, i shtohet fondi prej 5 363 000 (pesë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të zbatimit të projektit “Minimumi jetik, zyrtar”.
 3. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 4. Ngarkohen institucionet shtetërore të venë në dispozicion të grupit të punës të gjitha të dhënat e nevojshme, për zbatimin e këtij projekti.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

MINIMUMI JETIK ZYRTAR PROJEKT

Drejtues i Projektit
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
Tiranë, Dhjetor 2000

1. Çfarë është minimumi jetik?

Koncepti i pabarazisë ka qenë për një kohë të gjatë çështje e studimeve intensive midis ekonomistëve, statistikienëve, sociologëve, teoricienëve politikë, administratorëve dhe filozofëve.

Është kjo pabarazi që ekziston midis njerëzve që bashkëjetojnë në një ambient të caktuar që kushtëzon domosdoshmërinë e njohjes së pjesës më të varfër të popullsisë mbi bazën e një treguesi, i cili në terminologjinë ekonomike njihet si minimumi jetik.

Përcaktimet për treguesin e minimumit jetik janë të shumta, por, në përgjithësi, ai konsiderohet si një madhësi që tregon se sa duhet të jenë të ardhurat në para që duhet të disponojë një njeri që të mbijetojë.

Të gjithë ata persona të cilët disponojnë më pak të ardhura se kjo madhësi (që shpesh quhet dhe kufiri i varfërisë) konsiderohen të varfër.

Aktualisht, është bërë domosdoshmëri përcaktimi i treguesit zyrtar të minimumit jetik për zbatimin e ligjeve të Kuvendit, si: Kodit të Punës, Ligjit të Sigurimeve Shoqërore, nenit nr.27 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit” dhe porosive të organizatave botërore, si Organizata Botërore e Punës (ILO), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore si dhe kërkesave të vazhdueshme të Sindikatave.

Për përcaktimin e minimumit jetik përdoren mjaft metoda llogaritëse, por, në përputhje me mundësinë që ekzistojnë në Shqipëri, grupi i punës ka konkluduar se mund të përdoren si më të përshtatshme dy metoda:

Metoda analitike, e cila mbështetet në shportën e minimumit jetik dhe në madhësinë mesatare të çmimeve të artikujve.

Metoda relative e cila mbështetet në produktin kombëtar bruto mesatar për frymë.

Përse është i nevojshëm studimi dhe llogaritja e minimumit jetik?

Kryerja e këtij studimi është e nevojshme për këto arsye kryesore:

1. Në vendin tonë, aktualisht, mungojnë të dhëna zyrtare për treguesin e minimumit jetik. Në këtë mënyrë, vendi ynë është i vetmi ndër ish - vendet socialiste të Europës Lindore, pa tregues zyrtar të minimumit jetik të përcaktuar, që do të thotë se në vendin tonë mungon aktualisht metri i matjes së varfërisë.

2. Nga Organizata Botërore e Punës (ILO), Banka Botërore, FMN, Sindikatat dhe nga Kuvendi i Shqipërisë janë bërë herë pas here sugjerime për përcaktimin e treguesit zyrtar të minimumit jetik. Studimi njëherazi do të shërbejë edhe për hartimin e strategjive të rritjes ekonomike dhe të reduktimit të varfërisë.

3. Treguesi i minimumit jetik përdoret edhe në studime të tjera, për t’u krahasuar me pagat, pensionet etj, por edhe me të ardhurat gjithsej të punonjësve mbi bazën e buxheteve familjare.

4. Studimi do të shërbejë për të bërë krahasimin e minimumit jetik zyrtar për një të punësuar me pagën minimale dhe me madhësinë e pensioneve, të ndihmave sociale, të pagesës së papunësisë etj.

2. Objektivat e Projektit

Në bazë të studimit, do të përcaktohet treguesi i minimumit jetik.

Do të përcaktohet struktura e minimumit jetik për atikujt ushqimorë, artikujt e veshmbathjes, pajisje dhe orendi shtëpiake dhe shpenzime të tjera.

Do të bëhet krahasimi me vende të tjera të Europës Lindore dhe Perëndimore.

Do të studiohet papunësia për përcaktimin e koeficientit të ngarkesës për të punësuarit.

Do të studiohen të ardhurat reale të popullsisë së qytetit dhe fshatit duke bërë anketime të buxheteve familjare nëpërmjet Institutit të Statistikës.

3. Veprimtaritë e Projektit

Do të shfrytëzohen literatura bashkëkohore, si dhe studime të ndryshme që janë bërë nga universitetet, sindikatat etj, për mirëqenien dhe minimumin jetik.

Do të grumbullohen dhe do të studiohen të dhënat statistikore dhe financiare, mbi të ardhurat, indeksat e çmimeve etj, si nga vendi, ashtu edhe nga vendet e tjera.

Do të shfrytëzohen të dhënat e buxheteve familjare që ka Instituti i Statistikës dhe do të bëhen plotësimet e duhura për familjet fshatare. Kjo me qëllim që të krahasohet treguesi i minimumit jetik me të ardhurat e familjeve.

Do të organizohen takime, biseda dhe tavolina të rrumbullakta me institucione shkencore, me specialistë të bazës dhe punonjës të tjerë.

Do të merret përvoja nga vende të tjera të Europës dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si Organizata Botërore e Punës (ILO), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore BERZH, etj, nëpërmjet asistencës teknike, që do të përfitohet nga këto institucione, si dhe nëpërmjet kontakteve direkte me institucionet e vendeve europiane që e kanë llogaritur minimumin jetik në vendet e tyre do të synohet që të përfitohet një përvojë e pasur në këtë fushë.

Materiali përfundimtar i studimit do të diskutohet në Komisionin e Pagave dhe në Këshillin Kombëtar të Punës dhe pastaj do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave.

4. Rezultatet që priten

Do të përcaktohet dhe do të miratohet treguesi i minimumit jetik zyrtar në shkallë vendi për vitin 2000.

Do të sigurohen të dhënat statistikore në lidhje me punësimin, të ardhurat nominale dhe reale, indeksin e çmimeve, inflacionin etj.

Do të bëhen sugjerime për përsosjen e kuadrit ligjor në fushën e punësimit, mbrojtjes sociale dhe sigurimit social, si për Kodin e Punës, Ligjin e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Do të bëhen sugjerime në Këshillin e Ministrave dhe në organizma ndërkombëtare në lidhje me ngushtimin e diferencave midis minimumit jetik dhe të ardhurave për zvogëlimin e varfërisë. (Kjo sidomos në kuadrin e strategjisë për uljen e varfërisë).

5. Grupet e studimit dhe mbështetja

Studimi udhëhiqet nga Zëvendësministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

Për kryerjen e studimit do të ngrihet një Bord me përfaqësues nga Ministria e Financave, e Drejtësisë, e Shëndetësisë, e Pushtetit Lokal, Departamenti i Administratës Publike, Universiteti dhe nga partnerët sociale.

Bordi miraton të gjitha veprimet për grupin e studimit, afatet kohore, përbërjen e grupeve, si dhe të gjitha shpenzimet që do të kryhen në lidhje me projektin.

Bordi ka të drejtë të kontaktojë dhe të marrë informacione me të gjitha institucionet dhe organizmat për llogaritjen e minimumit jetik.

Në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale do të ngrihet një zyrë për administrimin e fondeve, mbajtjen e evidencës, evidentimin e shpenzimeve etj, si dhe funksionimin normal të aktivitetit të Bordit.

6. Veprimtaritë e Projektit dhe fondet që nevojiten (në mijë lekë).

Studimi fillon pas miratimit të tij nga Këshilli i Ministrave dhe përfundon pas 6 muajsh. Për këtë do të bëhet një program analitik me detyra konkrete, afati i zbatimit, si edhe organi përgjegjës. Studimi do të bëhet sipas të dhënave të vitit 2000.

Me miratimin e Projektit duhet të përgatitet një rregullore dhe program pune i detajuar, ku të përcaktohen të gjitha veprimtaritë, afati i kryerjes së tyre dhe personi përgjegjës para drejtuesit administrativ.

Projekti do të zhvillohet në tre drejtime kryesore:

1. Shfrytëzimi i literaturës dhe studimeve
2. Anketimi dhe mbledhja e të dhënave
3. Llogaritja e minimumit jetik mbi bazën e të dhënave dhe të anketave të përpunuara

Veprimtaritë kryesore të Projektit, të ndara në zëra sipas shpenzimeve të buxhetit janë si më poshtë vijon:

1. Grumbullim dhe studim literature nga vendi dhe e huaj, si dhe të dhëna statistikore dhe financiare që lidhen me mirëqenien, minimumin jetik, të ardhurat, çmimet etj.	270
2. Përpunim i anketave të buxheteve familjare të INSTAT-it dhe plotësim anketimi për familjet e fshatit.	300
3. Përpunim të dhënash të punësimit dhe plotësim anketash për studimin e papunësisë në qytet dhe në fshat.	450
4. Përcaktimi i nevojave të popullsisë për artikuj ushqimorë dhe shpenzime të tjera.	270
5. Dërgim grupesh për marrje përvoja në dy vende europiane dhe asistencë shkencore nga ILO.	1613
6. Organizim tavolinash të rrumbullakta.	90
7. Shpenzime kancelarie.	75
8. Shpenzime për shpërblimin e grupeve të studimit, sekretar-llogaritar të zyrës, oponentë, recensentë, redaktorë etj.	2250
9. Shpenzime për përgatitjen e Projektdraftit.	45
SHUMA	5363

Në përfundim, minimumi jetik i llogaritur dërgohet në Këshillin e Ministrave, i cili ka të drejtë shpalljen dhe publikimin e tij.

Shënim: Kthimi në lekë i USD është bërë me koeficientin 1USD=150 lekë

VENDIM
Nr. 120, datë 8.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996, “PËR PENSIONET SHTETËRORE, SUPLEMENTARE, TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimin nr.499, datë 21.9.2000 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nëntitullin “Për grupin e parë, germa “a” të pikës 8 të nenit 1 të këtij ligji”, në paragrafin “personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave”, bëhen këto ndryshime:

a) Emërtimi “Kryetar i Komitetit Kombëtar të RTV” zëvendësohet me emërtimin “Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit”;

b) Pas emërtimit “Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit” shtohet emërtimi “Guvernator i Bankës së Shqipërisë”;

2. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, germa “a” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji” në paragrafin “dhe personat e tjerë, të barazuar me ta, si më poshtë”, bëhen këto ndryshime:

a) Emërtimi “Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të RTV” zëvendësohet me emërtimin “Zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit”;

b) Emërtimi “Guvernator i Bankës së Shqipërisë”, zëvendësohet me emërtimin “Zëvendësguvernator i Bankës së Shqipërisë”;

c) Pas emërimit “Zëvendësguvernator i Bankës së Shqipërisë”, shtohet emërtimi “Inspektor i Përgjithshëm në Bankën e Shqipërisë”;

ç) Pas emërimit “Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil” shtohet emërtimi “Kryeinspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

3. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, germa “b” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, bëhen këto shtesa:

a) Pas emërimit “Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Civil dhe Ushtarak, në Tiranë”, shtohet emërtimi “Zëvendëskryeinspektor dhe inspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;

b) Pas emërimit “Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTV”, shtohet emërtimi “Drejtor Departamenti në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit”, si dhe emërtimi “Kryetar i Këshillit të Ankesave, në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit”.

4. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, germa “d”, të nenit 9 të këtij ligji, pas fjalëve “specialist në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendore dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit” shtohen fjalët “dhe në Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

5. Efektet financiare, në zbatim të këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit të secilit punonjës në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 121, datë 15.3.2001

PËR RREGULLAT E SIGURIMIT FIZIK TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 31, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. RREGULLA TË PËRGGJITHSHME

1. Me “sigurim fizik” kuptohet tërësia e masave, fizike dhe teknike, për ruajtjen e zonave, ndërtesave, dhomave dhe pajisjeve, ku ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”.

2. “Zona sigurie” janë zonat ku mbahen ose ruhen informacionet e klasifikuara, ku hyrja i nënshtrohet një regjimi të veçantë.

3. Mjediset dhe “zonat e sigurisë” duhet të vendosen në vende sa më pak të ekspozuara nga jashtë, që të sigurojnë mbikëqyrje të vazhdueshme, ditën dhe natën. Ato përcaktohen nga drejtuesi i institucionit.

4. Institucionet shtetërore, ku prodhohet, përpunohet, shpërndahet, transmetohet dhe ruhet informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, në përputhje me vëllimin e tij, kanë për detyrë të marrin masa për sigurimin e këtyre mjediseve. Këto mjedise pajisen me kasaforta e brava automatike. Zyrat dhe mjediset që ruajnë e administrojnë informacion të klasifikuar përdorin çelësa dhe dryna të veçantë nga ata të përdorimit të zakonshëm dhe vulosen me dyllë ose plasteline.

5. Mjediset për ruajtjen e informacioneve të niveleve “sekret” e “tepër sekret” rekomandohet, brenda mundësive, të mos jenë në katin e parë.

6. Dyerit e dritaret e tyre përforcohen me shufra hekuri dhe në të lejohet hyrja vetëm e personave të autorizuar.

7. Vendet për asgjësimin e shkatërrimin e informacionit të klasifikuar përcaktohen nga titullari i institucionit. Këto vende i nënshtrohen të njëjtit regjim sigurimi si edhe zonat e sigurisë.

8. Në rastet kur në mjediset dhe “zonat e sigurisë” së institucionit do të ketë vizitore, ata duhen të mbahen larg këtyre zonave. Rregullat e shoqërimit të tyre, me e pa shoqërues, përcaktohen me udhëzim të titullarit të institucionit.

9. Në mjediset ku diskutohet për informacionin e klasifikuar, të niveleve “sekret” dhe “tepër sekret”, duhen të merren masa për kontrollin e tyre, për të parandaluar vendosjen apo përdorimin e mjeteve të përgjimit, regjistrimit a të filmimit.

II. PËR SIGURIMIN FIZIK

1. Zbatimi i masave të sigurimit duhet të bëhet në përputhje me nivelin e informacionit të klasifikuar, sasinë e informacionit, me numrin e personelit që njeh dhe administron këtë informacion, si dhe treguesit e nivelit të rrezikut që mund të vijë nga ekspozimi i paautorizuar i informacionit të ruajtur.

2. Masat e sigurimit fizik kanë për qëllim mbrojtjen ndaj:

a) veprimtarisë së shërbimeve të huaja;

b) sulmeve terroriste dhe akteve të sabotazhit;

c) vjedhjes ose dëmtimit;

ç) hyrjes së qëllimshme nga persona të paautorizuar;

d) personave të paautorizuar për të hyrë në një nivel të caktuar informacioni.

3. Informacioni i klasifikuar të ruhet dhe të administrohet në zona ku publiku nuk mund të njihet me të.

4. Për ndalimin e hyrjes në mjediset ku ruhet dhe administrohet informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, i personave të paautorizuar është e domosdoshme që:

a) informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” të ruhet e të administrohet në zona të veçanta nga pjesët e tjera të objektit, ku nuk ndodhet një informacion i tillë;

b) të caktohen përreth “zonave të sigurisë” mjedise për qëllime kontrolli të personave dhe automjeteve;

c) të vendoset një regjim hyrje-daljeje, i cili të përcaktojë rregullat për të hyrë, qëndruar dhe dalë nga këto zona. I njëjti regjim të vendoset për ruajtjen e çelësave dhe të pajisjeve të tjera, që janë në funksion të “zonave të sigurisë”.

ç) të kontrollohen “zonat e sigurisë” nga personel i kualifikuar.

d) të përdoren pajisje dhe mjete të certifikuara dhe të kualifikuara, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

5. Informacioni i klasifikuar të ruhet në “zonat e sigurisë” nga çasti i krijimit për aq kohë sa është i klasifikuar. Me deklasifikimin e tij, ai do të ruhet si të gjithë dokumentet e tjera, të zakonshme.

6. Titullarët e institucioneve, që ruajnë e administrojnë informacion të klasifikuar, përcaktojnë dhe marrin masa për rregullat dhe procedurat e evakuimit të informacionit të klasifikuar, në rastet e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile, gjatë të cilave ky informacion mund të përvetësohet, dëmtohet, shkatërrohet a asgjësohet.

7. Institucionet shtetërore, që administrojnë informacion të klasifikuar, janë të detyruara të marrin masa për krijimin e pengesave fizike, të cilat mbikëqyren me roja ose me mjete teknike.

8. Këto pengesa fizike të jenë të tilla që:

a) të shmangin hyrjen me forcë ose në mënyrë të fshehtë të personave dhe të mjeteve të paautorizuara;

b) të bëjnë të mundur ndarjen e mjediseve për personelin brenda institucionit dhe futjen, në zonat e sigurisë vetëm në bazë të parimit të “nevojës për t’u njohur”;

c) të zbulojnë dhe ndalojnë veprimet e personelit të pandershëm, i cili ka marrë hyrje të paautorizuar ose përpjetë të hyjë në materiale me nivel më të lartë sigurie.

9. Personeli i shërbimit në këto mjedise të ketë në çdo kohë listën e personave të autorizuar për të hyrë në zonat e sigurisë, ku ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar.

10. Personeli i shërbimit të ketë edhe listën e institucioneve, të cilat duhet të thirren për çdo rast emergjent, si p.sh. shërbimet e policisë, shërbimin e zjarrfikësve, etj.

11. Personeli i shërbimit ka për detyrë shoqërimin, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes, të personave jonëpunës, të cilët kanë siguruar “certifikatë sigurie” për t’u njohur me informacionin e klasifikuar të institucionit.

III. SIGURIMI ME ROJA

1. Në mjediset ku ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar është e nevojshme që, përveç masave të tjera, të merren edhe masa për sigurimin me roja fikse dhe/ose të lëvizshme, gjatë 24 orëve.

2. Rojat janë përgjegjës për ruajtjen e mjediseve dhe të zonave të sigurisë, që u janë dhënë për ruajtje.

3. Patrullat janë roja të cilët shërbejnë për sigurimin e zonave të sigurisë gjatë ditëve të pushimeve, pas orarit të punës dhe në gjendje të veçanta.

4. Rregullat dhe vendi i shërbimit të rojave dhe i patrullave përcaktohet nga autoriteti që ka në zotërim informacionin e klasifikuar.

5. Rojat dhe patrullat u nënshtrohen kontrolleve të vazhdueshme, veçantërisht pas orarit të punës dhe gjatë natës.

6. Rojat dhe patrullat duhet t’i kenë të qarta detyrat që kryejnë dhe u bëhet instruksion i vazhdueshëm për shërbimin.

7. Kur mjediset kanë nevojë për shumë vendroja, sigurimi i tyre mund të bëhet edhe me sistem televiziv, sistem alarmi, mbikëqyrje të hyrjeve e daljeve.

8. Gjatë lëvizjes fizike të informacionit të klasifikuar brenda qytetit bëhet shoqërimi me një roje, ndërsa jashtë qytetit bëhet shoqërimi me dy roja, të armatosura.

9. Rojat kanë të drejtë të pengojnë çdo individ që lëviz në mjediset dhe zonat ku ka informacion të klasifikuar, nëse personi nuk tregon dukshëm shenjën dalluese.

IV. SIGURIMI ELEKTRONIK

1. Sigurimi elektronik ka për qëllim që, përveç masave të tjera të sigurimit, të vendosen pajisje, mjete dhe sisteme sinjalizimi e kontrolli, me qëllim marrjen e masave në rastet e ndërhyrjes nga persona të paautorizuar në mjediset e në “zonat e sigurisë”.

2. Në mjediset ku ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar “tepër sekret” të merren masa që, përveç masave dhe sistemeve të tjera të mbrojtjes, të vendosen pajisje dhe sisteme të sigurimit elektronik (sisteme sinjalizimi, telekamera, etj).

3. Në rastet e defekteve të sistemit të kontrollit elektronik, duhet të jenë të përcaktuar personat përgjegjës, të cilët do të ndërhyjnë për riparimin e tyre.

V. DISPOZITA TË VEÇANTA

1. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Drejtuësit e këtyre institucioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, detyrohen të nxjerrin udhëzime për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 122, datë 15.3.2001

**PËR SHQYRTIMIN E PASTËRTISË DHE PËR DHËNIEN E “CERTIFIKATËS SË
SIGURISË” PERSONAVE QË DO TË NJIHEN ME INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR
“SEKRET SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 25 e 31, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Kanë të drejtë të njihen, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” vetëm personat që pajisen me certifikatë sigurie”.
2. Të drejtën për të lëshuar “certifikatën e sigurisë” e ka Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), pranë Këshillit të Ministrave.
3. Lëshimi i “certifikatës së sigurisë” bëhet pasi kryhet verifikimi i pastërtisë së figurës së personit.
4. DSIK- ja ka të drejtë t’u kërkojë organeve që lidhen me sigurimin kombëtar e me rendin publik, organeve të drejtësisë dhe ministrive e institucioneve të tjera shtetërore, të dhëna për verifikimin e pastërtisë së figurës së personit.
5. Përfshihen nga verifikimi i pastërtisë së figurës dhe pajisen me “certifikatë sigurie” autoritetet klasifikuese, të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të cilët kanë të drejtë e gëzojnë automatikisht në çastin e emërimit, për aq kohë sa janë në këtë detyrë.

II. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT DHE TË CERTIFIKIMIT

1. Çdo institucion, që ka nevojë të pajisë me “certifikatë sigurie” punonjësit e vet, si dhe çdo person, që ka nevojë të njihet me një informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, duhet t’i paraqesë kërkesë DSIK-së.
2. Kërkesa bëhet vetëm pasi institucioni kërkues ka realizuar verifikimin paraprak, i cili përfshin emrin e personit, gjenealitetet, curriculum vitae-n, dëshminë e penaltetit, vërtetimet nga prokuroria e gjykata, se nuk është në ndjekje penale, vërtetimin nga Zyra e Përmbartimit, certifikatën e gjendjes familjare, nivelin e informacionit të klasifikuar me të cilin do të njihet, pëlqimin (autorizimin) e punonjësit, i cili është dakord dhe pranon që ndaj tij të mblidhen të dhëna dhe të bëhen verifikime nga organet përkatëse për pastërtinë penale, gjendjen pasurore, gjendjen shëndetësore (sipas formularit përkatës).
3. DSIK-ja, në bazë të kërkesës dhe të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, kur i gjen të plota, u kërkon institucioneve përkatëse, që lidhen me sigurimin kombëtar, rendin kushtetues, rendin publik, me organet e drejtësisë dhe me ministrinë e institucionet e tjera shtetërore, verifikimin e punonjësit.
4. Verifikimi i së kaluarës dhe i gjendjes së sotme bëhet në të gjithë regjistrat dhe dokumentet e institucioneve të përcaktuara më lart.
5. DSIK-ja në bazë të autorizimit të lëshuar nga punonjësi, kryen verifikimin në institucionet financiare, shëndetësore e ato që i gjykon të nevojshme dhe që i shërbejnë certifikimit.
6. Institucionet, të cilave me ligj u është njohur e drejta për të bërë verifikime për punonjësit e vet, për këtë qëllim, zbatojnë procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

7. DSIK-ja, në bazë të këtij verifikimi dhe propozimit të titullarit të institucionit, pasi ka përfunduar verifikimin dhe pasi e vlerëson në përputhje me ligjin, lëshon “certifikatën e sigurisë”.

8. Procedura e verifikimit të një personi, të cilit i është hedhur poshtë kërkesa për pajisjen me “certifikatë sigurie”, me kërkesë të titullarit, mund të rifillojë, pas kalimit të një viti nga data e mospranimit të kërkesës, me vlerësimin e shkaqeve që kanë sjellë këtë mospranim.

9. Në rastet e mospajisjes së punonjësit me “certifikatë sigurie”, DSIK-ja duhet të njoftojë institucionin kërkues.

Në këto raste, institucioni ka të drejtë të ankohet te Kryeministri, vendimi i të cilit është përfundimtar.

10. Të drejtën për njohje me një informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” të një institucioni e gëzojnë edhe persona të tjerë, që nuk janë punonjës të këtij institucioni vetëm pasi të jetë shprehur dakord autoriteti klasifikues që zotëron informacionin e kërkuar. Kur institucioni e gjen të bazuar në ligj, i kërkon DSIK-së lëshimin e “certifikatës së sigurisë”, sipas procedurave të mësipërme.

11. DSIK-ja mban “Regjistrin e personave të certifikuar” në shkallë vendi, sipas institucioneve, sipas nivelit të certifikimit, si dhe të dhëna të tjera, të nevojshme.

12. DSIK-ja mban gjithashtu “Regjistrin e personave të pajisur me “certifikatë sigurie të përkohshme””, me afat të përcaktuar dhe informacion të klasifikuar, të cilësuar në shkallë vendi.

III. LLOJET E “CERTIFIKATËS SË SIGURISË”

1. Për informacionin e klasifikuar, në nivelin “konfidencial”, lëshohet certifikatë e kategorisë “A”, e vlefshme për 10 vjet.

2. Për informacionin e klasifikuar në nivelin “sekret”, lëshohet certifikatë e kategorisë “B”, e vlefshme për 5 vjet.

3. Për informacionin e klasifikuar në nivelin “tepër sekret”, lëshohet certifikatë e kategorisë “C”, e vlefshme për 3 vjet.

4. Forma dhe modeli i “certifikatës së sigurisë” përcaktohen nga DSIK-ja.

5. Për personat e punësuar me kontratë, “certifikata e sigurisë” lëshohet me vlefshmëri deri në përfundim të afatit të kontratës.

6. Për personat e përcaktuar në pikën II.10, të këtij vendimi, “certifikata e sigurisë”, lëshohet sipas nivelit të informacionit të klasifikuar që kërkohet të njihet. Certifikata lëshohet për aq kohë sa e kërkon qëllimi i tij i ligjshëm.

7. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, “certifikata e sigurisë”, lëshohet duke ndjekur të njëjtat procedura, si për herë të parë.

8. Kur në ngarkim të një personi të certifikuar dalin të dhëna, ose kur ka ndryshime të gjendjes së pasqyruar në pyetësonin e sigurisë personale, të cilat kanë të bëjnë me garancinë që duhet të ketë mbajtësi i certifikatës, institucioni njofton DSIK-në, e cila, pas verifikimit, brenda 1 muaji nga data e njoftimit, vendos për heqje ose jo të “certifikatës së sigurisë”.

9. Certifikata e kategorisë “A” lëshohet nga DSIK-ja në bazë të dokumentacionit dhe të verifikimit të bërë për kandidatin, nga vetë institucioni, të cilit, me ligj, i është njohur kjo e drejtë.

10. Certifikata e kategorisë “B” lëshohet nga DSIK-ja, në bazë të dokumentacionit dhe të verifikimit të bërë për kandidatin, nga institucioni, të cilit, me ligj, i është njohur kjo e drejtë dhe nga DSIK-ja.

11. Certifikata e kategorisë “C” lëshohet nga DSIK-ja, në bazë të dokumentacionit dhe të verifikimit të bërë për kandidatin dhe personat madhorë, familjarët dhe të afërmit e tij, nga vetë institucioni, që, me ligj, i është njohur kjo e drejtë dhe nga DSIK-ja.

12. Certifikata e kategorisë më të lartë i jep të drejtë mbajtësit të saj të njihet edhe me nivelet më të ulta të informacionit të klasifikuar.

13. Për lëshimin e “certifikatës së sigurisë” , të kategorive “A”, “B” dhe “C”, afati i kthimit të përgjigjes nga DSIK-ja, të jetë, respektivisht, 1,2 dhe 3 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

IV. ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTEVE

1. Pranë DSIK-së krijohet dhe funksionon sektori i administrimit të dokumenteve.
2. Dokumentacioni i grumbulluar, gjatë procedurës së verifikimit të punonjësve të institucioneve, të cilave, me ligj, u njihet e drejta e verifikimit, u kthehet për ruajtje këtyre institucioneve.
3. “Certifikata e sigurisë” lëshohet në bazë të vlerësimit të përshtatshmërisë me detyrën, besnikërisë ndaj Republikës së Shqipërisë, ndikimit të jashtëm, figurës dhe qëndrimit moral, sjelljes personale, sjelljes ndaj drogës e alkoolit, gjendjes financiare, qëndrimit ndaj sigurisë kombëtare dhe rendit publik, gjendjes mendore, qëndrimit ndaj informacionit të klasifikuar.
4. Procedura për lëshimin e “certifikatës së sigurisë” duhet të garantojë paanshmërinë, balancimin e interesave dhe mosçenimin e dinjitetit të personit.

V. RREGULLA TË VEÇANTA

1. Ngarkohen DSIK-ja dhe titullarët e institucioneve që, brenda 3-muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjnë certifikimin e punonjësve që njihen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” ose e administrojnë atë.
2. Për punonjësit, të cilët në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të pajisen me “certifikatë sigurie”, të zbatohen procedurat e përcaktuara në këtë vendim.
3. Ngarkohen ministrinë e institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM Nr. 124, datë 15.3.2001

PËR DEKLASIFIKIMIN E ZHVLERËSIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”, QË NDODHET NË RRJETIN KOMBËTAR TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrjetin kombëtar të arkivave, të ngrihen Komisionet për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin (KDZH) të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, i cili përfshihet në çfarëdolloj fondi dokumentar.
2. Komisioni i Deklasifikimit e Zhvlerësimit përbëhet nga jo më pak se 5 persona. Kur ekziston prodhuesi i informacionit të klasifikuar, në komision merr pjesë, detyrimisht, edhe një përfaqësues i tij.
3. Titullari i institucionit, që ka në zotërim informacionin e klasifikuar, është kryetari i KDZH-së, ndërsa drejtuesi i arkivit, që administron informacionin e klasifikuar, objekt i deklasifikimit ose zhvlerësimit, është nënkryetar i këtij komisioni. Sekretar komisioni caktohet fondruajtësi i informacionit të klasifikuar.

4. KDZH-ja, për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar, zbaton kriteret e përcaktuara në nenin 13, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, si dhe listat tip, të dokumenteve “sekret shtetëror”, të institucionit prodhues të origjinës.

5. Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, që kanë hyrë në arkiva, të emërtuara "sekret shtetëror", sipas niveleve, zbatohen kriteret dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

6. Dokumentet në ruajtje, që trashëgohen në rrjetin kombëtar të arkivave, të ardhura prej subjekteve fondkrijuese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk u nënshtrohen deklasifikimit dhe zhvlerësimit deri në 150 vjet nga data e krijimit.

7. KDZH-ja merr për dokumentet që ndodhen në arkivat e sistemit, vendim për deklasifikimin ose zhvlerësimin e tyre, ndërsa kur vëren se dokumentet i përkasin institucioneve të tjera eprore, ua përcjell atyre për veprim, duke u kërkuar vendimin përkatës.

8. Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar, KDZH-ja:

a) kur ekziston prodhuesi i informacionit, merr mendimin e tij;

b) kur ekziston një organ, që ka trashëguar veprimtarinë e organit të origjinës, merr mendimin e tij;

c) kur nuk ekziston organi i origjinës (prodhuesi), zbaton nenin 23, të ligjit nr.7726, dsatë 29.6.1993, “Për fondin arkivor kombëtar dhe arkivat”, duke marrë mendimin e specializuar të një përfaqësuesi të një institucioni, fusha e veprimtarisë e të cilit është e përafërt me objektin e trajtuar nga informacioni.

9. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e tij, KDZH-ja, vendos:

a) ruajtjen e nivelit të klasifikimit, të përcaktuar në listë, sipas afatit të ruajtjes;

b) uljen e nivelit të klasifikimit, të përcaktuar në listë;

c) përjashtimin nga deklasifikimi ose zhvlerësimi, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 16, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

10. Rrjeti kombëtar i arkivave harton bibliografinë e informacionit të deklasifikuar, e cila përmban ndryshimet në statusin e këtij informacioni, që nga krijimi, zhvlerësimi, deklasifikimi, etj.

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar i vihet në dispozicion, për njohje dhe përdorim, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

11. Publiku mund të njihet me informacionin e deklasifikuar, në raste dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.7726, datë 29.6.1993, “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat.

12. Informacioni i klasifikuar, i përjashtuar nga deklasifikimi, i nënshtrohet rishikimit sistematik të deklasifikimit, sipas procedurave të këtij vendimi.

13. Shërbimi Informativ Kombëtar, në bashkëpunim me organet e tjera informative, ka të drejtën e rekomandimit të procedurave të veçanta për deklasifikimin e informacionit, për rastet e parashikuara në ligj.

14. Ngarkohen ministritë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Drejtuesit e këtyre institucioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, detyrohen të nxjerrin udhëzim për zbatimin e tij.

15. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 2, datë 26.1.2001

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 8093, DATË 21.3.1996 “PËR REZERVAT UJORE”
DHE TË VENDIMIT NR. 63, DATË 26.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PROCEDURAT E KËRKIMIT, TË SHQYRTIMIT DHE TË DHËNIES SË
AUTORIZIMEVE, TË LEJEVE DHE KONCESIONEVE PËR PËRDORIMIN
E REZERVAVE UJORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6,7,12,18 dhe 72, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O J:

I. PROCEDURAT PËR KONCESIONE

A. PROCEDURAT PËR PROPOZIMET E KËRKUARA

Kur Këshilli i Basenit Ujëmbledhës (KBU) ose Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), sipas planeve kombëtare ose të baseneve ujëmbledhëse për rezervat ujore ose studimeve të tjera specifike, arrin në përfundimin se një rezervë ujore mund të jepet për shfrytëzim me koncesion, ai merr një vendim për përdorimin e rezervës ujore për qëllime të specifikuar në vendim. Agjencia e Ujit (Agjencia) ose Sekretariati Teknik i KKU (Sekretariati) përgatitin dhe ndjekin zhvillimin e procedurave të tenderit, deri në klasifikimin e pjesëmarrësve, nëpërmjet një liste vlerësimi të propozimeve dhe, pas miratimit të kësaj liste nga Autoritetet e Ujit, ajo ndjek përpilimin e projektkontratës.

Format e tenderit

Tenderi i hapur do të përdoret për prurjet sipas rreshtave 1 – 2 të tabelës nr.1 dhe rreshtit 1 të tabelës nr.2.

Tenderi ndërkombëtar do të përdoret për prurjet sipas rreshtit 3 – 6 të tabelës nr.1 dhe rreshtit 2-4 të tabelës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Përgatitja e tenderit

2.1.Shpallja e tenderit do të bëhet nëpërmjet njoftimit në media e gazeta për të mundësuar pjesëmarrjen e subjekteve të interesuara:

a. Për tenderin e hapur - në të paktën dy gazeta kombëtare dhe një vendore të zonës ku ndodhet baseni ku do të zhvillohet projekti;

b. Për tenderin ndërkombëtar, në një gazetë të njohur ndërkombëtare si dhe në gazetën e përfshira në shkronjën (a), për të tërhequr një numër sa më të madh ofertash.

2.2. Njoftimi për shpalljen e tenderit do të përmbajë këto të dhëna:

Emrin e burimit ujor dhe tipin e tij;

Procedurën e tenderit;

Vendndodhjen e burimit;

Karakteristikat kryesore (prurja, kimizmi, etj) të burimit;

Qëllimet e përdorimit (pa e kufizuar të drejtën e subjekteve për propozime të tjera);

Adresa e agjencisë pranë të cilës do të paraqiten të interesuarit (sipas klasifikimit për kompetencat e Autoriteteve të Ujit, të cilat jepen me Vendim të Këshillit të Ministrave).

Afatin dhe çmimin e tërheqjes së dokumenteve të tenderit pranë agjencisë përkatëse.

2.3. Afati i dorëzimit të propozimeve. Periudha ndërmjet afatit të tërheqjes së dokumentacionit të tenderit dhe të dorëzimit të propozimeve do të jetë:

Jo më pak se 60 ditë për tenderin e hapur,

Jo më pak se 90 ditë për tenderin ndërkombëtar.

Të interesuarit do të paraqiten pranë Agjencisë ose Sekretariatit, ku do të marrin kërkesat e dokumentacionit që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në tender, si dhe sqarimet e nevojshme për plotësimin dhe afatet e dorëzimit të tyre.

2.4. Dokumentacioni i tenderit përbëhet nga dy pjesë:

A. Dokumentet që përgatit Agjencia a Sekretariati:

-1. Udhëzim për pjesëmarrësit në tender. Ky udhëzim përfshin:

afatin e dorëzimit të dokumenteve

ditën dhe orën e kualifikimit

shpjegimin e pjesëve përbërëse të formularit të kërkesës, plotësimit të tyre, etj;

datën e shpalljes së listës së vlerësimit të propozimeve (jo më pak se 1 muaj pas afatit të dorëzimit), etj.

2. Termat e referencës së kontratës.

Këto dokumente i dorëzohen subjekteve pjesëmarrëse në tender, së bashku me formularin e kërkesës për koncesion (të miratuara në K KU) që duhet të plotësojë subjekti i interesuar.

B. Dokumentacioni që dorëzon pjesëmarrësi në tender në Agjenci (Sekretariati), është në përputhje me formularin e kërkesës, i ndarë në tre zarfa të veçantë si vijon:

formulari i aplikimit dhe dokumentacioni juridik,

dokumentacioni teknik,

dokumentacioni ekonomik-financiar.

Përveç dokumentacionit të mësipërm Agjencia ose Sekretariati, kur e shih të nevojshme mund t'u kërkojë pjesëmarrësve në tender edhe dokumente ose informacione të tjera.

3. Zhvillimi i tenderit

3.1 Dorëzimi i propozimeve dhe kualifikimi i pjesëmarrësve

I gjithë dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet në dy dosje me materiale origjinale.

Pjesëmarrësit në tender do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të përgatitura nga Agjencia (Sekretariati) sipas pikës 2.4 A të këtij udhëzimi. Nëse Agjencia (Sekretariati) shih të domosdoshëm ndonjë ndryshim apo plotësim dokumentacioni, kjo duhet t'i komunikohet pjesëmarrësve, brenda një periudhe të mjaftueshme kohe për të kryer këto ndryshime ose plotësime, përpara afatit të dorëzimit të propozimeve.

Në ditën dhe orën e caktuar në udhëzim (pika 2.4. A/1) Agjencia (Sekretariati) në prani të gjithë subjekteve që kanë sjellë propozime shqyrton zarfet me formularin e aplikimit e dokumentet juridike. Plotësimi i gjithë dokumenteve juridike dhe rregullsia e tyre do të shërbejë si kusht kualifikimi. Subjektet që kanë mangësi ose parregullsi në këto dokumente, përjashtohen nga tenderi. Subjekteve të kualifikuara u njoftohet edhe njëherë data e shpalljes së listës së vlerësimit, sipas kriterëve të vlerësimit me pikë.

3.2 Kriteret e vlerësimit të propozimeve

1. Dokumentacioni juridik hapet i pari dhe shërben si kriter kualifikimi për pjesëmarrjen e mëtejshme.

2. Vlerësimi i dokumentacionit teknik

Maksimumi i mundshëm në pikë

25

- Projekti i shfrytëzimit të rezervave ujore

5

- Sasia më e vogël e përdorimit të ujit (l/s)

10

- Cilësia e pajisjeve që do të përdoren

5

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis

5

3. Vlerësimi i dokumentacionit ekonomik

75

- Tarifa më e lartë e pagesës, e propozuar nga konkurruesi për njësinë e ujit (ku tarifa më e ulët është ajo sipas vendimit të Këshillit të Ministrave "Për tarifën e përdorimit të rezervave ujore")

28

- Periudha më e shkurtër e koncesionit

15

- Periudha më e shpejtë për vënien në shfrytëzim të objektit

5

- Frytshmëria dhe vënia në punë e investimit

10

- Përvoja në fushën e përdorimit të propozuar të ujit

5

- Mundësia financiare për investimin, besueshmëria i huasë së mundëshme,

3

etj.

- Niveli i plotësimit të kërkesave për ofertë	2
- Besueshmëria e ofertës (mundësia reale për realizimin e ofertës së tarifës)	7
Shuma (pika 2 + pika 3)	100

Në çdo rast subjekti kualifikohet nëse plotëson 75 pikë nga 100 të mundshme.

3.3. Shqyrtimi i propozimeve dhe shpallja e listës së vlerësimit

Agjencia a Sekretariati shqyrton propozimet (dokumentacionin teknik dhe ekonomik - pika 5B-2, 3) e subjekteve të kualifikuara dhe, duke u bazuar në kriteret e vlerësimit sipas pikës 3.2 të këtij udhëzimi, harton listën e vlerësimit të tyre në pikë. Kjo listë shpallet, në prani të të gjithë subjekteve pjesëmarrëse në tender, në datën e përcaktuar në udhëzim (pika 2.4.A-1). Nëse për arsye objektive kjo datë shtyhet, kjo u njoftohet subjekteve me shkrim.

Procedura e mësipërme dhe vlerësimi në pikë zhvillohet edhe sikur të ketë një propozim të vetëm.

Nëse dy apo më shumë subjekte vlerësohen me pikë të barabarta, ka përparësi subjekti i cili ka kryer një studim të rezervës ujore në bazë të një autorizimi të dhënë nga Autoritetet e Ujit. Në rastet e tjera ka përparësi subjekti që ofron tarifën më të lartë të pagesës për përdorimin e rezervës ujore.

Subjektet që kanë ankesa për listën e vlerësimit të Agjencisë a Sekretariatit, kanë të drejtë të ankohen pranë kryetarit të KBU-së, K KU-së brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së listës së vlerësimit.

3.4. Miratimi i listës së vlerësimit dhe shpallja e fituesit

Autoriteti i Ujit që vendos rezultatin e tenderit, është ai që përcaktohet në kolonat 6 dhe 7 të tabelës nr.1 dhe 2 të Vendimit nr.63, datë 26.1.2001 të Këshillit të Ministrave të cilit i bashkëlidhet ky udhëzim. Mbledhja për shqyrtimin e listës së vlerësimit dhe të ankesave të mundshme do të zhvillohet jo më parë se 1 muaj nga data e shpalljes së kësaj liste. Agjencia a Sekretariati, përgatit materialin përkatës për këtë mbledhje. Në mbledhje, Autoriteti i Ujit, miraton me një vendim listën e vlerësimit duke shpallur fituesin e tenderit, ose, kur konstaton parregullsi në procedurat e vlerësimit të propozimeve, ia kthen për rishqyrtim dokumentacionin e tenderit Agjencisë a Sekretariatit.

Agjencia a Sekretariati ka për detyrë të mbajë procesverbalet e mbledhjes, të cilat së bashku me dokumentacionin e tenderit do të përfshihen në një dosje me emërtimin e tenderit. Dosja ruhet pranë Agjencisë a Sekretariatit, në përputhje me ligjin “Për Arkivat”. Këto dokumente vihen në dispozicion të organeve të autorizuara për kontroll apo verifikim.

Agjencia a Sekretariati brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit të KBU-së, K KU-së shpall listën e vlerësimit të miratuar nga KBU-ja a K KU-ja pranë Agjencisë a Sekretariatit dhe njofton subjektin fitues të paraqitet për të nënshkruar një kontratë me kusht për ecurinë e mëtejshme të procedurës për lidhjen e kontratës. Në rastet kur dokumentacioni kthehet për rishqyrtim, kjo njoftohet nëpërmjet shpalljes pranë Agjencisë a Sekretariatit si dhe nëpërmjet lajmërimit të subjektit.

Çdo konkurrues ka të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve ndaj vendimit të miratimit të listës së vlerësimit dhe shpalljes së fituesit nga autoritetet e ujit.

Për nënshkrimin e kontratës me kusht, subjekti fitues duhet detyrimisht të paraqesë një garanci bankare, (ngurtësim i shumës 2 për qind të vlerës së investimit të parashikuar).

3.5. Kontrata me kusht

Kontrata me kusht është një akt juridik, që nënshkruhet nga Agjencia a Sekretariati dhe subjekti fitues. Ajo do të përmbajë të paktën:

Deklarim nga të dy palet për të lidhur kontratën e koncesionit, sipas termave të referencës, të dhëna në dokumentacionin e tenderit.

Afatin prej 6 muajsh të vlefshmërisë së kësaj letre mirëkuptimi.

Sipërmarrjen e subjektit që brenda 3 muajve të paraqesë një projektkontratë së bashku me:

Dokumentin e aftësisë profesionale për aktivitetin e kërkuar.

Aktmarrëveshjen për blerje ose marrjen me qira të truallit ku do të investohet ose vendimin e KRRT-së (RSH) për shesh ndërtimi.

Në rast se subjekti nuk e siguron dot dokumentin e pronësisë, për koncesione me interesa kombëtare, subjekti duhet të bëjë një kërkesë pranë Autoriteteve të Ujit për fillimin e procedurave të shpronësimit në përputhje me dispozitat në fuqi. (Në këtë rast shpenzimet do të mbuloen nga subjekti).

Për subjektet e huaja kërkohet vërtetimi i regjistrimit si person juridik shqiptar (vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë) dhe si person i tatueshëm (NIPT).

Kushtin që subjektit fitues i humbet e drejta e marrjes së koncesionit dhe i mbahet garancia bankare për sigurimin e lidhjes së kontratës, nëse brenda 3 muajve ai nuk plotëson detyrimet sipas kësaj kontrate, dhe nëse brenda 6 muajve nuk arrihet, për faj të tij, të përfundohet një projektkontratë e pranueshme për të dyja palët. Në këtë rast njoftohet të paraqitet për negociim subjekti i kualifikuar i dyti dhe nëse ai pranon përsëritet procedura duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me kusht së mirëkuptimit. Në rast se subjekti nuk është më i interesuar, ftohet subjekti i kualifikur në listën e vlerësimit e kështu me rradhë.

3.6. Miratimi i projektkontratës dhe lidhja e kontratës

Agjencia a Sekretariati gjatë periudhës së negociimit të projektkontratës mund të kryejë kontrolle dhe sondazhe për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura nga fituesi i tenderit. Për këtë do të ndihmojnë të gjithë institucionet e specializuara shtetërore si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, ambasadat tona të akredituara në shtetet e tjera, etj.

Kur pas negociimeve midis Agjencisë a Sekretariatit dhe subjektit, arrihet në përfundim që projektkontrata e paraqitur nga subjekti (pas ndryshimeve të mundshme si rezultat i negociimeve) është e pranueshme për të dyja palët, ajo nënshkruhet nga drejtori i Agjencisë a Sekretariatit dhe përfaqësuesi ligjor i subjektit. Në këtë rast Agjencia a Sekretariati i kërkon një mbledhje KBU-së a KKU-së për miratimin e saj. Në mbledhje është i pranishëm edhe përfaqësuesi ligjor i subjektit.

Në këtë mbledhje KBU-ja a KKU-ja merr vendim për miratimin ose jo të kontratës. Në rastin e mos miratimit të projektit të paraqitur për korrigjime apo plotësime të nevojshme, ai i kthehet Agjencisë për reflektimin e vërejtjeve (në negociim me subjektin). Pas korrigjimeve, projekti paraqitet përsëri për miratim në KBU a KKU.

Në rastin kur projekti miratohet nga KBU-ja a KKU-ja, kontrata nënshkruhet nga Kryetari i KBU-së a KKU-së dhe përfaqësuesi ligjor i subjektit.

Për rastet kur miratimi është e drejtë e Këshillit të Ministrave, projektkontrata e miratuar nga KKU-ja i dërgohet, për miratim Këshillit të Ministrave.

B. Procedurat për propozimet e pakërkua

Kur pranë Agjencisë a Sekretariatit paraqitet një propozim i pakërkuar për përdorim rezerve ujore, e cila nuk është shpallur nga autoritetet e ujit, studiohen parametrat kryesore të këtij burimi dhe impaktet e shfrytëzimit të tij si dhe vlerësohet nëse ky burim mund të jepet për shfrytëzim ose jo. Agjencia a Sekretariati mund të kërkojë oponencë nga organet apo institutet e specializuara financiare dhe teknike, për propozimin si dhe vlerësime nga Këshilli Teknik ngritur pranë saj, në përputhje me Rregulloren e Agjencisë a Sekretariatit. Në rastet kur vlerësohet se burimi mund të jepet për përdorim, kërkohet nga KBU-ja a KKU-ja “miratimi, në parim” sipas pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave. Pas kësaj vepohet si në paragrafin A; “Procedurat për propozimet e kërkuara”.

Nëse nuk paraqitet asnjë subjekt tjetër i interesuar propozuesi njoftohet të paraqitet për nënshkrimin e kontratës me kusht, duke zbatuar procedurat e pikës A 3.5.

2. PROCEDURAT PËR LEJE

A. Procedurat për Propozimet e Kërkuara

Në mbështetje të planeve kombëtare ose të baseneve ujëmbledhese për rezervat ujore, kur vlerësohet se një rezervë ujore mund të jepet për shfrytëzim me leje, Agjencia a Sekretariati përgatit dhe ndjekin zhvillimin e procedurave të tenderit.

Forma e tenderit

Forma e tenderit do të jetë “Tenderi i hapur”.

2. Përgatitja e tenderit

2.1. Shpallja e tenderit do të bëhet nëpërmjet njoftimit në media dhe në të paktën dy gazeta kombëtare dhe një vendore në zonën ku ndodhet baseni, ku do të zhvillohet projekti.

2.2. Njoftimi për shpalljen e tenderit do të përmbajë këto të dhëna:

Emrin e burimit ujqor dhe tipin e tij;

Vendndodhjen e burimit;

Karakteristikat kryesore (prurja, kimizmi, etj) të burimit;

Qëllimet e përdorimit (pa e kufizuar të drejtën e subjekteve për propozime të tjera);

Adresën e agjencisë pranë së cilës do të paraqiten të interesuarit (sipas klasifikimit për kompetencat e autoriteteve të ujit, të cilat jepen me vendimin e Këshillit të Ministrave);

Afatin dhe çmimin e tërheqjes së dokumenteve të tenderit pranë agjencisë përkatëse.

2.3. Afati i dorëzimit të propozimeve. Periudha ndërmjet afatit të tërheqjes së dokumentacionit të tenderit dhe të dorëzimit të propozimeve do të jetë jo më pak se 60 ditë.

Të interesuarit do të paraqiten pranë Agjencisë a Sekretariatit, ku do të marrin kërkesat e dokumentacionit që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në tender si dhe sqarimet e nevojshme për plotësimin dhe afatet e dorëzimit të tyre.

2.4. Dokumentacioni i tenderit përbëhet nga dy pjesë:

A. Dokumentacioni që përgatit Agjencia a Sekretariati:

Udhëzimi për pjesëmarrësit në tender, i cili përfshin:

- Afatin e dorëzimit të dokumenteve;

- Ditën dhe orën e kualifikimit;

- Shpjegimin e pjesëve përbërëse të formularit të kërkesës, plotësimit të tyre, etj;

- Datën e shpalljes së listës së vlerësimit të propozimeve (jo më pak se 1 muaj pas afatit të dorëzimit).

Ky udhëzim i dorëzohet subjekteve pjesëmarrëse në tender, së bashku me formularin e kërkesës për leje (të miratuara në KKU) i cili duhet të plotësohet nga subjekti.

B. Dokumentacioni që dorëzon pjesëmarrësi në tender në Agjenci a Sekretariat, është sipas formularit të kërkesës, i ndarë në dy zarfe të veçantë si vijon:

1. Formulari i aplikimit dhe dokumentacioni juridik;

2. Dokumentacioni tekniko-financiar.

Përveç dokumentacionit të mësipërm Agjencia a Sekretariati, kur është e nevojshme, mund t’ju kërkojë pjesëmarrësve në tender edhe dokumente ose të dhëna të tjera.

3. Zhvillimi i tenderit

3.1. Dorëzimi i propozimeve dhe kualifikimi i pjesëmarrësve

I gjithë dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet në përputhje me pikën 2.4 B, në dy dosje, me materiale origjinale. Nëse Agjencia a Sekretariati sheh të domosdoshëm ndonjë ndryshim apo plotësim dokumentacioni, kjo duhet t’u njoftohet pjesëmarrësve, brenda një periudhe të mjaftueshme kohe për realizimin e këtyre ndryshimeve ose plotësimeve, përpara afatit të dorëzimit të propozimeve.

Në ditën dhe orën e caktuar në udhëzimin (pika 2.4 A), Agjencia a Sekretariati, në prani të gjithë subjekteve që kanë sjellë propozime shqyrton zarfet me dokumentet juridike. Plotësimi i gjithë dokumentave juridike dhe rregullsia e tyre do të shërbejë si kusht kualifikimi. Subjektet që kanë mangesi ose parregullsi në këto dokumente, përjashtohen nga tenderi. Subjekteve të kualifikuara iu njoftohet edhe njëherë data e shpalljes së fituesit.

3.2. Kriteret e vlerësimit të propozimeve

1. Dokumentacioni juridik hapet i pari dhe shërben si kriter kualifikimi për pjesëmarrjen e mëtejshme në tender.

2. Vlerësimi i dokumentacionit tekniko-financiar	Maksimumi i mundshëm në pikë
- Projekti i shfrytëzimit të rezervave ujore	25
- Humbjet më të vogla gjatë përdorimit të rezervës ujore	10
- Pajisjet që do të përdoren.	10
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis	10
- Përvoja në fushën e përdorimit të propozuar të ujit	5
- Mundësia financiare për investimin	10
- Investime për mbrojtjen e rezervës ujore, brigjeve, përmirësimin e cilësisë etj	10
- Periudha për vënien në shfrytëzim të rezervës ujore	20
- Frutshmëria dhe vënia në punë e investimit	10
Shuma	100

Ne çdo rast subjekti kualifikohet nëse plotëson 75 pikë nga 100 të mundshme.

3.3. Shqyrtimi i propozimeve dhe shpallja e fituesit

Agjencia a Sekretariati shqyrton propozimet (dokumentacionin tekniko- financiar, pika 2.4 B-2) e subjekteve të kualifikuara dhe, duke u bazuar në kriteret e vlerësimit sipas pikës 3.2 të këtij udhëzimi, harton listën e vlerësimit të tyre në pikë. Kjo listë paraqitet për miratim në mbledhjen e KBU-së a Sekretariatit. Për rastet kur veprimtaria, për të cilën është kërkuar leja për përdorimin e rezervës ujore, është “lundrim” ose “ndërtim strukturash ankoruese dhe portuale”, lista e vlerësimit do të paraqitet për miratim në KKU. Agjencia a Sekretariati ka për detyrë të mbajë procesverbalet e mbledhjes për miratimin e listës së vlerësimit, të cilat së bashku me dokumentacionin e tenderit do të përfshihen në një dosje me emërtimin e tenderit. Dosja ruhet pranë Agjencisë a Sekretariatit, në përputhje me ligjin “Për arkivat”. Këto dokumente vihen në dispozicion të organeve të autorizuar për kontroll apo verifikim.

Subjekti i kualifikuar i pari në listën e vlerësimit shpallet fitues dhe kjo i njoftohet të gjithë pjesëmarrësve në tender. Subjektet pjesëmarrëse kanë të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të miratimit të listës së vlerësimit dhe shpalljes së fituesit nga autoritetet e ujit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit. Nëse brenda 5 ditëve, Agjencia a Sekretariati nuk ka njoftim për ankim në gjykatë, ajo njofton subjektin fitues që pas 20 ditëve të paraqitet për të tërhequr lejen për përdorimin e rezervës ujore.

Procedura e mësipërme dhe vlerësimi në pikë zhvillohet edhe sikur të ketë një propozim të vetëm.

B. Procedurat për propozimet e pakërkuara

Kur pranë Agjencisë a Sekretariatit paraqitet një propozim i pakërkuar për përdorim me leje të një rezerve ujore (e cila nuk është shpallur nga autoritetet e ujit) studiohen parametrat kryesore të këtij burimi dhe impaktet e shfrytëzimit të tij. Agjencia a Sekretariati mund të kërkojë oponencë nga organet apo institutet e specializuara, financiare dhe teknike, për propozimin si dhe vlerësime nga Këshilli Teknik ngritur pranë saj, në përputhje me Rregulloren e Agjencisë a Sekretariatit për të vlerësuar nëse ky burim mund të jepet për shfrytëzim ose jo. Në rastet kur vlerësohet se burimi mund të jepet për përdorim, veprohet si në paragrafin A: “Procedurat për propozimet e kërkuara”. Në rast të kundërt subjektit i njoftohet që propozimi i tij nuk pranohet.

3. PROCEDURAT PËR AUTORIZIME

Kur pranë Agjencisë a Sekretariatit, paraqitet një kërkesë për autorizim për kërkim, studim apo zbulim në ujrat sipërfaqësore apo nëntokësore, Agjencia a Sekretariati e publikon këtë kërkesë sipas rregullave të tenderit të hapur të përcaktuara në vendim, për të evidentuar nëse ka subjekte të tjera të interesuara për të njëjtin studim.

Njoftimi do të përmbajë këto të dhëna:

Emrin e burimit ujor;

Vendndodhjen e burimit;

Qëllimin e studimit;

Afatin e paraqitjes të të interesuarve (jo më pak se 15 ditë).

Nëse nuk paraqitet subjekt tjetër i interesuar, subjektit të parë i jepet për të plotësuar formulari i kërkesës për autorizim. Brenda 45 ditëve subjekti duhet të dorëzojë pranë Agjencisë a Sekretariatit propozimin (formularin e aplikimit së bashku me dokumentacionin e kërkuar).

Kur propozimi paraqitet pranë Agjencisë, kjo e fundit, pasi e shqyrton atë, e paraqet për miratim në KBU, në përputhje me rregulloren e KBU-së.

Kur propozimi paraqitet pranë Sekretariatit, ky i fundit e shqyrton dhe e miraton ose jo, në përputhje me rregulloren e vet.

Nëse paraqiten subjekte të tjera të interesuara (brenda afatit të përcaktuar në shpallje), Agjencia a Sekretariati njofton të gjithë të interesuarit për zhvillimin e procedurës së tenderimit duke njoftuar dhe afatin e tërheqjes së dokumentacionit të tenderit.

1. Dokumentacioni i tenderit përbëhet nga dy pjesë:

A. Dokumentacioni që përgatit Agjencia a Sekretariati

Udhëzimi për pjesëmarrësit në tender, i cili përfshin:

- afatin e dorëzimit të dokumentave;

- ditën dhe orën e kualifikimit;

- shpjegimin e pjesëve përbërëse të formularit të kërkesës, plotësimit të tyre, etj;

- datën e shpalljes së listës së vlerësimit të propozimeve (jo më pak se 1 muaj pas afatit të dorëzimit).

Ky udhëzim i dorëzohet subjekteve pjesëmarrëse në tender, së bashku me formularin e kërkesës për autorizim (të miratuar nga KBU) që duhet të plotësojë subjekti.

Dokumentacioni që dorëzon pjesëmarrësi në tender pranë Agjencisë a Sekretariatit:

1. Formulari i Aplikimit dhe Dokumentacioni Juridik;

2. Dokumentacioni teknik.

Ky dokumentacion duhet të jetë sipas formularit të kërkesës, i ndarë në dy zarfa të veçantë sipas pikave 1 dhe 2. Përveç këtij dokumentacioni Agjencia ose Sekretariati, kur është e nevojshme mund t'u kërkojë pjesëmarrësve në tender edhe dokumente ose të dhëna të tjera.

2. Afati i dorëzimit të propozimeve. Periudha ndërmjet afatit të tërheqjes së dokumentacionit të tenderit dhe të dorëzimit të propozimeve do të jetë jo më pak se 30 ditë.

3. Dorëzimi i propozimeve dhe kualifikimi i pjesëmarrësve

I gjithë dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet sipas pikës 1 B, në dy dosje me materiale origjinale. Nëse Agjencia a Sekretariati sheh të domosdoshme ndonjë ndryshim apo plotësim dokumentacioni, kjo duhet t'i njoftohet pjesëmarrësve, brenda një periudhe të mjaftueshme kohe për realizimin e këtyre ndryshimeve ose plotësimeve, përpara afatit të dorëzimit të propozimeve.

Në ditën dhe orën e caktuar, në udhëzim (pika 1A) Agjencia a Sekretariati, në prani të gjithë subjekteve që kanë sjellë propozime, shqyrton zarfet me dokumentet juridike. Plotësimi i gjithë dokumenteve juridike dhe rregullsia e tyre do të shërbejë si kusht kualifikimi. Subjektet, që kanë mangësi ose parregullsi në këto dokumente, përjashtohen nga tenderi. Subjekteve të kualifikuara u njoftohet edhe njëherë data e shpalljes së fituesit.

4. Kriteret e vlerësimit të propozimeve

1. Dokumentacioni juridik hapet i pari dhe shërben si kriter kualifikimi për pjesëmarrje të mëtejshme në tender.

2. Vlerësimi i dokumentacionit teknik

Maksimumi i mundshëm në pikë

- Projekti i kërkimit (studimit apo zbulimit)

50

- Afati më i shkurtër i kryerjes së studimit

10

- Ndikimi sa më i vogël në mjedis

15

- Niveli i teknikës dhe i teknologjisë që do të përdoret

15

- Përvoja në fushën e studimit

10

Shuma

100

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe shpallja e fituesit

Agjencia a Sekretariati shqyrton propozimet (dokumentacionin teknik-pika 1 B-2) e subjekteve të kualifikuara dhe, duke u bazuar në kriteret e vlerësimit sipas pikës 4-2 të këtij paragrafi, përpilon listën e vlerësimit të tyre në pikë. Kjo listë paraqitet për miratim në mbledhjen e KBU-së (Sekretariatit).

Agjencia a Sekretariati ka për detyrë të mbajë procesverbalet e mbledhjes, për miratimin e listës së vlerësimit, të cilat, së bashku me dokumentacionin e tenderit do të përfshihen në një dosje me emërtimin e tenderit. Dosja ruhet pranë Agjencisë a Sekretariatit, në përputhje me ligjin “Për arkivat”. Këto dokumente vihen në dispozicion të organeve të autorizuara, për kontroll apo verifikim.

Subjekti i kualifikuar i pari në listën e vlerësimit shpallet fitues dhe kjo u njoftohet të gjithë pjesëmarrësve në tender. Subjektet pjesëmarrëse kanë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit të autoriteteve të ujit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.

Nëse brenda 5 ditëve, Agjencia a Sekretariati nuk ka njoftim për ankim në gjykatë, ajo njofton subjektin fitues që pas 20 ditëve të paraqitet për të tërhequr autorizimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNEVE PUBLIKE

Spartak Poçi

KOMPETENCAT E AUTORITETEVE TË UJIT PËR MIRATIM KONCESIONESH

(Në funksion të qëllimit të përdorimit dhe të sasisë së ujit)

TABELA NR.1
REZERVË UJORE PËR UJË TË PIJSHËM DHE TË KONFEKSIONUAR

Nr	Qëllimi i përdorimit	Njësi	Prurja		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KB U	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjenc i e Ujit	Sek.Tek i KKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	Për pirje	l/sek	0	100						
2.	Për konfeksionim	“	0	5						
3.	Për pirje	“	100	2000						
4.	Për konfeksionim	“	5	300						
5.	Për pirje	“	> 2000							

TABELA NR.2
REZERVË UJORE PËR UJITJE DHE HIDROENERGJI

Nr	Qëllimi i përdorimit	Njësi	Prurja		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjensi e Ujit	Sek.Tek. i KKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.			< = 1							
2.	Ujë për ujitje dhe për hidroenergji	Min/m 3 në vit	1	5						
3.			5	10						
4.			10							

UDHEZIM
Nr. 3, date 28.2.2001

PËR PERDORIMIN EFEKTIV TE FONDEVE PER INVESTIMET PUBLIKE
PER VITIN 2001

Ne zbatim te programit te qeverise per perdorimin ekonomik dhe efektiv te fondeve publike nga buxheti i shtetit, por edhe ato nga donatore dhe te ardhurat vendore;

per te ndihmuar administraten e organeve te qeverisjes vendore per zbatim te njeje te kerkesave te akteve normative;

mbeshtetur ne nenin 102 pika 4 te kushtetutes, në ligjin nr. 8718, datë 19.12.2000 “Per Buxhetin e Shtetit per vitin 2001”, udhezimet e Ministrise se Financave nr. 2, datë 2.2.2001 dhe Ministrise se Pushtetit Lokal nr. 2, datë 10.02.2001 “ Per zbatimin e Buxhetit te Shtetit” dhe gjithë aktet normative ne fuqi “Per Prokurimin Publik”,

U D H E Z O J :

1. Fondet per investimet publike nga Ministria e Pushtetit Lokal te perfshira ne Buxhetin e Shtetit per vitin 2001, te detajuara sipas objekteve dhe 4 mujoreve, per organin tuaj jane derguar me shkresen tone Nr 227 date 28.02.2001.

Ministria e Financave i ka akorduar keto fonde prane degeve te Buxhetit ne rrethe me shkresen nr. 689/1, dt. 5.2.2001, me te cilat duhet te rakordoni dhe t'i dergoni detajimin ne periudha 2 mujore, sipas institucioneve te vartesisë suaj.

1.1. Per pershpejtimin e punimeve te ndertimit dhe sherbimit, lejohet avancimi i fondeve te financimit nga 4 mujoret pasardhes te vitit.

1.2. Investimet qe do te mbeten pa prokuruar deri më datën 1.11.2001 do te bllokohen. Ato ç'bllokohen vetem me urdher te Ministrit te Financave, pas motivimit te arsyetuar te Ministrise se Pushtetit Lokal.

1.3 Procedurat e prokurimit konsiderohen te perfunduara ne daten kur depozitohet ne degen e buxhetit shkresa e miratimit te ofertes fituese dhe çeljes se fondeve nga organi qendror ose vendor.

1.4- Vlera e paradhanes gjate lidhjes per ndertime dhe rikonstruksione lejohet deri ne 10% te vleres se kontrates, ne varesi te madhesisë dhe kompleksitetit te vepres.

1.5- Ndalohet ngurtesimi i fondeve ne llogari te klientit per pune te pakryera per te gjithë kontratat e investimeve dhe sherbimeve.

2. Te gjithë organet e qeverisjes vendore dhe investitoret, ne zbatim te nenit 12 te ligjit nr. 8718, datë 19.12.2000 “Per Buxhetin e Shtetit te vitit 2001” bejne publike ne vende te dukshme jo me vone se 10 dite nga data e miratimit, investimet nga te ardhurat e tyre, nga fondi rezerve dhe Buxheti i Shtetit, si dhe permes informimit ne median e shkruar dhe elektronike lokale ose kombetare.

3. Deget e Buxhetit ne rrethe autorizojne çeljen e fondeve per investime prane degeve te Thesarit, brenda 3 diteve pasi marrin programin ose shitesat e investimeve nga Drejtoria e Buxhetit dhe konfirmimin me shkrim per miratim prokurimi e celje fondi nga urdheruesi i fondeve te organit qendror ose lokal ne vartesi te vleres se percaktuar ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 335 datë 23.06.2000 “Per rregullat e Prokurimit Publik”.

4. Procedurat e prokurimit te fondeve te programuara per investime dhe sherbime behen nga entet prokuruese te percaktuara nga Ministria e Pushtetit Lokal.

4.1. Procedurat e prokurimit fillojne menjehere, me synim qe brenda muajit qershor te perfundojne gjithë prokurimet per ndertime.

4.2. Deri ne nje urdher te dyte, prokurimet per investimet dhe kontratat per to do te behen per vlerat vjetore te programuara.

4.3. Preventivi pjesor i punimeve te ndertimit per vitin 2001, per vepra qe vazhdojne me shume se nje vit mbeshtetet ne projektin dhe preventivin e plote te vepres dhe punimet e prokuruar ne vitet e merparshme.

4.4. Ministria e Pushtetit Lokal do te detyrohet te beje transferime te fondeve te paprokuruara per investime, ne menyre qe keto fonde te behen efektive.

5. Prokurimet publike do te kryhen dhe dokumentat e tenderit do te plotesohen duke respektuar me perpikmeri kerkesat e akteve normative:

5.1. Dispozitat e ligjit nr. 7971, datë 26.07.1995 “Per prokurimin publik dhe ndryshimet ne te (faqe 184-204 te permbledheses së legjislacionit per organet e Pushtetit Lokal te Republikes se Shqiperise)”.

5.2. Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 335, datë 23.06.2000 “Per rregullat e prokurimit publik” (faqe 985-988 te Fletores Zyrtare nr. 20 te vitit 2000) .

5.3. Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr. 1 datë 1.1.1996 “Per prokurimin publik”(faqe 208-223 te Permbledheses së Legjislacionit per Organet e Pushtetit Lokal te Republikes se Shqiperise)”.

5.4. Dokumentet standarde te tenderit miratuar me vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 12 datë 1.1.1996 (faqe 224-224, 256-265 te Permbledheses se Legjislacionit per Organet e Pushtetit Lokal te Republikes se Shqiperise)”.

6. Titullari i entit prokurues, leshon urdherin e prokurimit konform kerkesave te kapitullit te pare te udhezimit nr 1, datë 1.1.1996 “Per prokurimin publik” duke pasur parasysh kryesisht:

6.1. Procedura e prokurimit qe do te perdoret (tenderi hapur, i kufizuar, i drejtperdrejte, kerkese per kuotim etj.) dhe afati nga dita e shpalljes se fteses per oferte deri ditën e dorezimit te saj te caktohen konform pikave 1,2,3,4 dhe 5 te vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 23.6.2000 “Per rregullat e prokurimit publik”.

6.2. Kryetari i komisionit te vleresimit te ofertave rekomandohet te jete zevendestitullari i entit prokurues. Titullari i entit prokurues nuk mund te jete kryetar i komisionit per vleresimin e ofertave.

6.3. Ne rastet kur organet e qeverisjes vendore, qe jane ne rolin e entit prokurues, nuk kane specialiste te fushes perkatese per plotesimin e komisionit te vleresimit dhe njesise se prokurimit, u rekomandohet te angazhojne specialiste te institucioneve, ne varesi, ose specialiste te jashtem.

6.4. Titullari i entit prokurues ben shpalljen e kerkeses per oferte, minimumi 10 dite pasi e perezjell zyrtarisht ate per botim ne Agjencine e prokurimit publik prane Keshillit te Ministrave .

Per tenderin e hapur duhet te behet ne kohen e duhur publikimi i fteses per oferte, ne te pakten dy gazeta kombetare me tirazh te madh.

6.5. Per kandidatet qe kane plotesuar kerkesat minimale per kualifikim (dokumentacioni ligjoro-administrativ, kualifikimet licencat, makinerite e pajisjet ne dispozicion, vleren minimale te objekteve te ngjashme te ndertuar nga sipermarresi), enti prokurues te perdore si kriter vleresues, çmimin me te ulet, duke i dhene jo me pak se 80 pike dhe afatin e kryerjes se punimeve, duke i dhene jo me shume se 20 pike.

Kur afati i perfundimit te punimeve te prokuruara caktohet ne dokumentet e tenderit, kriter i vetem vleresues mbetet çmimi me i ulet i ofertes.

6.5.a. Klasifikimi i ofertave te kualifikuara behet ne baze te formule llogaritese, dhene ne te njejtin udhezim.

6.5.b. Per prokurimin e studim- projektimit zbatohen kerkesat e veçanta, te percaktuara ne udhezimin e Keshillit te Ministrave nr 1, datë 1.1.1996 “Per prokurimin publik”.

6.5.c. Vendimet e komisionit eshte mire te merren me konsensus dhe kur ky nuk arrihet, me shumicen e votave te deklaruar (jo me votim te fshehte).

6.6- Nga dita e njoftimit zyrtar te konkurreseve prej komisionit per vleresimin e ofertave, deri ne shpalljen e fituesit duhet te kalojne 10 dite per evidentimin dhe zgjidhjen e ankesave te ofertuesve.

7. Enti prokurues, krahas kerkesave per kualifikim te percaktuara me ligjin dhe udhezimin, e sipershenuar, “Per prokurimin publik” ka te drejte te shtoje ne dokumentet e tenderit edhe kerkesa te tjera si:

7.1. Punime te ngjashme realizuara tre vitet e fundit nga ofertuesi, me vlere jo me pak se 50% e vleres se objektit qe prokurohet, vertetuar zyrtarisht nga investitori, te shoqeruar me aktin e kolaudimit te vepres dhe, ne raste te veçanta, me fotografi.

7.2. Llojin dhe numrin e mjeteve dhe makinerive te nevojshme per realizimin e punimeve me cilesi dhe afat, vertetuar me akte pronesia ose kontrata qiramarrje te noterizuara.

7.3. Personelin inxhiniero-teknik te punesuar dhe pajisur me licencen perkatese, per realizimin e objektit qe prokurohet dhe numrin e punonjesve te ndertimit gjithsej dhe te specializuar, vertetuar me kontrata pune dhe me sigurimet shoqerore.

7.4. Regjistrimin e ofertuesit si tatim-pagues me tvsh .

7.5. Vellimin e punimeve qe do te realizohet me nensipermarrje.

7.6. Kerkesat per kualifikim te percaktuara ne ligjin "Per prokurim publik", ne formularin "Te dhenat e ofertes" dhe pikat 7.1-7.5 te ketij udhezimi te jene te harmonizuara dhe te mos jene mosperputhje.

8. Per objektet e prokuruar me vlere nen 5 milionë leke, procedurat e prokurimit miratohen nga titullari i entit prokurues dhe njoftohet Ministria e Pushtetit Lokal per subjektin fitues te tenderit, vleren e ofertes fituese, preventivin e punimeve te prokuruar dhe afatin e perfundimit te tyre, aktin e organit qe ka miratuar projektpreventivin dhe vleren e plote te vepres qe prokurohet.

8.1- Duke respektuar afatin 10 ditor te evidentimit te ankesave, titullari i entit prokurues njofton degen e Buxhetit ne rreth qe te autorizojne per celjen e fondeve ne degen e Thesarit.

9. Per objektet e prokuruar me vlere 5-100 milionë leke, enti prokurues, pas kalimit te afatit te pritjes se ankesave, paraqet per shqyrtim paraprak dhe miratim tek titullari i Ministrise se Pushtetit Lokal dokumentacionin e meposhtem:

9.1. Kopje e fteses per oferte derguar ne Agjensine e Prokurimit Publik dhe per tenderin e hapur kopjet e gazetave ne te cilat eshte botuar ftesa per oferte.

9.2. Kopje e urdherit te prokurimit, ne te cilin duhet te evidentohen sipas kerkesave te kapitullit te pare te udhezimit te Keshillit te Ministrave nr. 1, datë 1.1.1996 "Per prokurimin publik" objekti qe prokurohet, vlera e plote e vepres dhe vlera qe prokurohet (kur objekti zgjat me shume se nje vit), llojin e tenderit qe do te perdoret, komisionin e vleresimit te ofertave me jo me pak se 5 anetare (per projektimet jo me pak se 7 anetare specialiste te fushes), njesine e pergatitjes se dokumenteve (njesia e prokurimit) me jo me pak se 3 anetare, njeri nga te cilet detyrimisht jurist, etj.

9.3. Kopje e shkreses se miratimit te projektpreventivit dhe vleres se plote te objektit qe prokurohet nga organi kompetent.

9.3 a. Preventivi i objektit, miratuar nga investitori dhe kryetari i entit prokurues (kur vepra vazhdon me shume se nje vit, kerkohet pervec preventivit sipas vleres se plote edhe preventivi pjesor per vleren qe prokurohet).

9.4. Kopje e listes se kandidateve te azhornuar per konkurim, pasqyruar ne vendimin e Komisionit te vleresimit te ofertave.

9.5. Preventivi i dhene subjekteve konkurrues me vellimet e punes dhe normat maksimale qe enti prokurues gjykon te pranueshme per tvsh, fitim, shpenzime plotesuese, fond rezerve, tarife projektimit etj.

9.6. Proces-verbalet e vendimet e komisionit, pasqyrat e vleresimit te ofertave te kualifikuara dhe e plotesimit te kerkesave per kualifikim nga konkurruesit, te gjitha te nenshkruara rregullisht nga anetaret e komisionit dhe njesia e prokurimit.

9.7. Raportin permblledhes, nenshkruar nga kryetari i entit prokurues ne te cilin duhet te pasqyrohen gjithte fazat e prokurimit, deri tek vleresimi perfundimtar i kryetarit te entit prokurues per rregullaritetin e procedurave.

9.8. Kopje e ofertes fituese nenshkruar nga komisioni i vleresimit te ofertave.

9.9. Kerkesa per celje fondi me vleren e ofertes fituese.

9.10. Kur dokumentet ne orgjinal jane vetem ne nje kopje ato ruhen në dosjen e entit prokurues dhe fotokopjet e tyre te konfirmuara me firme e vule te njome nga antaret e njesise se prokurimit dhe titullari i entit prokurues percillen ne Ministrine e Pushtetit Lokal.

9.11. Pas shqyrtimit te dokumentacionit dhe miratimit te procedurave te mesiperme nga titullari Ministrise behet celja e fondeve nga Drejtoria e Finances ne degët e Buxhetit ne rreth.

10. Dokumentet sipas pikes 9 dergohen zyrtarisht ne Drejtorine e Programimit te Investimeve ne Ministrine e Pushtetit Lokal.

10.1. Dokumentacioni i paraqitur sipas pikes 9 shqyrtohet nga nje komision i posaçem, qe krijohet me urdher te titullarit. Afati i shqyrtimit te jete per çdo rast jo me shume se 7 dite.

10.2. Per rastet e ankesave per procedurat e prokurimit publik, vendos per trajtim te metejshem titullari i Ministrise.

11. Per objektet e prokuruar ne vlere me shume se 100 milionë leke dokumentet sipas pikes 9 percillen ne Agjencine e Prokurimit Publik prane Keshillit te Ministrave.

12. Organet e qeverisjes vendore per investimet qe do te realizojne me te ardhurat e tyre ose nga donatoret, kryejne gjithë procedurat e prokurimit, si me lart, pa qene nevoja te percjellin per shqyrtim ne Ministrine e Pushtetit Lokal dokumentacionin sipas pikave 8,9 te ketij udhezimi.

13. Ankesat ndaj veprimeve apo procedurave te entit prokurues, si rregull, i paraqiten sipas radhes entit prokurues, organit vendor apo qendror investitor, dhe ne fund Agjencise se Prokurimit Publik, ne perputhje me nenet 43-45 te ligjit “ Per prokurimin publik ” dhe pikes 12 te vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 23.06.2000.

14. Enti prokurues, perpara perfundimit te afatit te vlefshmerise se ofertes, ben shpalljen e ofertes fituese sipas dokumentit standard, duke kerkuar me mirekuptim, ne afatin me te shkurter te mundshem, formularin standard te kontrates te nenshkruar (ne asnje rast jo me shume se 15 dite).

14.1- Njoftimi i fituesit hap rrugen per nenshkrimin e kontrates midis paleve, e cila hartohet ne perputhje me “KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER PUNIMET E NDERTIMIT” per te gjitha llojet e tenderave, perjashtuar prokurimin sipas kerkeses per kuotim (faqe 235-244 e permbledhesit te legjislacionit per organet e pushtetit lokal te Republikes se Shqiperise)

14.1a. Ne rastet kur enti prokurues perdor “ Kerkesen per kuotim” kontrata lidhet ne perputhje me pjesen C te “ FTESE PER KUOTIM PER PUNIME TE VOGLA NDERTIMI ” (faqe 259 - 262 e permbledhesit te legjislacionit per organet e pushtetit lokal te Republikes se Shqiperise).

14.2. Kontrata te hartohet nga specialiste te fushes perkatese, per te caktuar qarte detyrimet reciproke, pergjegjesite dhe sanksionet. Ajo behet efektive pasi nenshkruhet rregullisht nga enti prokurues, investitori dhe sipermarresi.

14.2a. Çdo shtese kontrate eshte e vlefshme pasi te nenshkruhet nga te tre palet.

15. Ministra e Pushtetit Lokal per vitin 2001 u rekomandon investitoreve dhe enteve prokurues:

15.1. Ne preventivat qe do t’u jepen kandidateve te percaktohen kufijte maksimale per shpenzime plotesuese dhe per normen e fitimit; vlera e fondit rezerve te jete 3-5%.

15.2. Studim projektimet te mbulohen me fondet e programuara ne kete ze, nga te ardhurat ne zbatim te ligjit “ Per urbanistiken”, te vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 201, datë 26.3.1998 “Per kriteret e perdorimit te te ardhurave nga shitja dhe qiraja e truallit” e te çdo akti tjetër normativ dhe nga te ardhurat e organeve te qeverisjes vendore.

15.2a. Ne raste te veçanta, per vepra mbi 5 milionë leke, Ministria e Pushtetit Lokal autorizon financimin e tyre nga vlera e ndertimit, konform vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 444 datë 5.9.1994.

15.3. Per vepra mbi 5 milionë lekë, kur investitori nuk ka struktura te specializuara per mbikqyrjen e kolaudimin e punimeve, me miratim te Ministrise se Pushtetit Lokal, caktohen fondet perkatese nga vleraa e ndertimit.

15.4. Periudhat e garancise per defekte, qe shenohen ne kontrate, caktohen nga specialistet perkates te njesise prokurimit, duke pasur parasysh kerkesat e kushteve teknike te projektimit dhe ndertimit, te detyrueshme per zbatim.

15.5. Kur i njeiti ent prokurues ka me shume se nje objekt te nje lloji (ndertese administrative, çerdhe, rruge, qender shendetësore etj) rekomandohet te perdore procedurat e parakualifikimit per objekte me vlefte te plote mbi 10 milion leke.

16. Ministria e Pushtetit Lokal cakton organet dhe institucionet qe do te jene ne rolin e investitorit dhe entit prokurues.

16.1. Kur investitori dhe enti prokurues jane dy organe te ndryshme, ky i fundit i dorezon investitorit gjithë kopjet e dokumenteve te tenderit, projektin, preventivin perfundimtar dhe pjesor, oferten fituese, grafikun e punimeve para lidhjes se kontrates me sipermarresin.

16.2. Investitori vete dhe me strukturat ne varesi ndjek me perparesi realizimin e investimeve ne kohe e cilesi, konform kushteve teknike te projektimit, zbatimit dhe standardeve te detyrueshme.

Drejtori dhe kolaudatori i punimeve caktohen nga investitori, konform kerkesave te ligjit "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit " dhe udhezimit nr. 3, datë 15.2.2001 te Keshillit te Ministrave "Per mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit".

16.3. Investitori informon per realizimin e investimeve sipas rregullave te vendosura ne ligjin e statistikes, aktet normative ne fuqi dhe udhezimet e Ministrise se Pushtetit Lokal.

17. Ky udhezim zbatohet per te gjithë investimet e programuara nga Ministria e Pushtetit Lokal per vitin 2001.

18. Me zbatimin e ketij udhezimi ngarkohen gjithë organet, qe u vihen ne dispozicion fonde nga Ministria e Pushtetit Lokal; me kontrollin e zbatimit te tij, Drejtoria e Programimit te Investimeve, Drejtoria e Finances, Departamenti i Kontrollit Financiar ne Ministrine e Pushtetit Lokal dhe Drejtorite e Kontrollit ne prefektura.

MINISTRI I PUSHTETIT LOKAL
Bashkim Fino

VENDIM "NE EMER TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 12.01.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.89/2 Akti që u përket:

K E R K U E S: SHEFQET MUÇI, IDAJET HOXHA, SELFO DOSTI, përfaqësues të të gjykuarve në mungesë Baki e Albert Huqi.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PERGJITHSHEM, i përfaqësuar nga Arqile Lole, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

O B J E K T I

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.371, datë 27.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar si antikushtetues vendimin nr.371, datë 27.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 17.04.2000, kanë vendosur në të njëjtën mënyrë si në vendimin e tyre të mëparshëm, duke prishur vendimin nr.48, datë 10.03.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe pushimin e gjykimit të çështjes në shkallë të dytë.

Kërkuesit parashetrojnë në kërkesën e tyre se:

- Mohimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i të drejtës së avokatit të të gjykuarit në mungesë, të caktuar kryesisht apo pajisur me akt përfaqësimi nga familjarët, për të bërë ankim, përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe cënon të drejtën e mbrojtjes;

- Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili në kundërshtim me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nuk njeh dhe as zbaton vendimin e Gjykatës Kushtetuese, përbën shkelje të Kushtetutës.

Prokurori i thirrur në seancë me cilësinë e subjektit të interesuar kërkoi shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm krahas argumentit për zbatimin e detyrueshëm të vendimit të Gjykatës Kushtetuese edhe për arsye se rekursin e prokurorit Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e kanë shqyrtuar.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi u njoh me përmbajtjen e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, dëgjoji relatorin, gjyqtarin Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.17, datë 17.04.2000, në çështjen me kërkues avokatët Shefqet Muçi, Idajet Hoxha dhe Selfo Dosti kundër vendimit nr.386, datë 29.07.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të këtij vendimi dhe dërgimin për shqyrtim të çështjes po kësaj gjykate.

Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë cënuar të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet mohimit të të drejtës për t'u mbrojtur dhe të drejtës për gjykim, të garantuara në nenet 31, shkronja "c" dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe pavarësisht nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, përsëri kanë vazhduar t'i qëndrojnë mënyrës së mëparshme të interpretimit të normave procedurale-penale në bazë të vendimit të tyre, tashmë të shfuqizuar, duke konkluduar përfundimisht se: "mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata ose i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet në mungesë të të pandehurit për të mbrojtur interesat e tij, nuk është person i legjitimuar për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit". Gjithashtu, ato kanë arritur në përfundimin se "procesi i gjykimit të kësaj çështjeje (në Gjykatën e Lartë) është zhvilluar rregullisht".

Ky konkluzion i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kundërshton në mënyrë të hapur arsyetimin dhe përfundimin që ka arritur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj, lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor, përbën njërin aspekt të vendimit të tyre.

Të gjitha argumentet e tjera që parashtrohen në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat lidhen me kryerjen e funksioneve kushtetuese, apo me kufijtë e pushteteve e të kompetencave të secilit organ, janë përmbledhur kryesisht në pasazhet e poshtëshënuara, të shkëputura nga ky vendim, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese duke e shqyrtuar këtë çështje dhe nëpërmjet argumenteve që do të parashtrojë, të kryejë edhe interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese, të cilave u referohet.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin e tyre, ndërmjet të tjerave, arsyetojnë:

- Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese "...nuk gjenden interpretime përfundimtare të normave kushtetuese, por vetëm pohimi se janë shkelur parimet kushtetuese të mbrojtjes në procesin penal e të garantimit të një procesi të rregullt ligjor...".

- Interpretimi i një sërë normash të Kodit të Procedurës Penale "...del jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese e nuk formon jurisprudencë kushtetuese...". "...Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të bëjë interpretim të ligjit...". "Interpretimi i unifikuar i ligjeve është në juridiksionin ekskluziv të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë..." dhe "...Askush tjetër nuk mund të zëvendësojë Gjykatën e Lartë as nuk mund të dalë mbi të e t'i imponohet në këtë funksion ekskluziv kushtetues...".

- “Nxjerrja e konkluzioneve nga Gjykata Kushtetuese...e nxjerrin atë jashtë kufijve të pushteteve që i jep Kushtetuta dhe për rrjedhojë janë të papranueshme...”. “...Ajo nuk mund të rrëzojë interpretimin kushtetues pozitiv të bërë nga Gjykata e Lartë...”.

Duke i analizuar në tërësi këto pasazhe në kontekstin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë e duke marrë shkas edhe nga konceptet që shfaqen e konkluzionet që ato përpiqen të arrijnë, Gjykata Kushtetuese çmon se është e drejtë, por njëkohësisht edhe detyrë e saj, të argumentojë dhe të rikonfirmojë, nëpërmjet këtij procesi gjyqësor se ajo është autoriteti i vetëm i ngarkuar të zgjidhë nëpërmjet vendimeve përfundimtare dhe të detyrueshme për të gjithë, çdo lloj mosmarrëveshje të kompetencës ndërmjet pushteteve, të garantojë respektimin e Kushtetutës dhe të bëjë interpretimin përfundimtar të saj, funksion i cili asaj i buron veçse nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Në dispozitivin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 17.04.2000 ka dy elementë të rëndësishëm që lidhen me shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe me dërgimin e kësaj çështjeje për shqyrtim pranë këtij organi. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar të zbatojnë formalisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese vetëm për njërin element të tij, që lidhet me detyrimin për të rishqyrtuar këtë çështje, ndërsa për argumentet që janë parashtruar në pjesën arsyetuese dhe ngrihen çështje të parregullsive dhe të shkeljeve të së drejtës së mbrojtjes dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ato nuk u janë bindur, por e kanë zgjidhur çështjen në kundërshtim me këtë interpretim kushtetues.

Kërkuesit, duke marrë shkak nga ky qëndrim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë parashtruar përsëri në kërkesën e tyre pretendimet për mohimin e të drejtës së ankimit të avokatit, si përfaqësues i të gjykuarve në mungesë dhe cënimin e procesit të rregullt ligjor në çështjen konkrete, por Gjykata Kushtetuese çmon se shqyrtimi dhe analiza e mëtejshme e argumenteve kushtetuese të përdorur në vendimin e mëparshëm të saj, do të përbënin gjë të gjykuar.

Në parim vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese kanë autoritetin absolut të gjësë së gjykuar dhe prodhojnë efekte “erga omnes”, pra për të gjithë. Në rastin konkret, çështja që trajton të drejtën e avokatit për të bërë ankim, si përfaqësues i të gjykuarit në mungesë, i caktuar kryesisht ose nga familjarët e të pandehurit, është zgjidhur njëherë e përgjithmonë në mënyrë definitive dhe sipas parimit “res judicata” ajo nuk mund të rishikohet përsëri në të ardhmen. Pikërisht, zgjidhjen përfundimtare, kjo çështje e ka marrë tashmë me vendimin nr.17, datë 17.04.2000 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “Caktimi i mbrojtësit në mënyrat dhe kriteret e parashikuara nga ligji, përfshirë dhe mbrojtësin e caktuar kryesisht dhe njëkohësisht e drejta e tyre për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, ka për qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor në të gjitha shkallët e gjykimit, siç përcaktohet edhe në nenin 2/2 të Protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në nenin 14/5 të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike”.

Pretendimi tjetër i kërkuesve që lidhet me moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që sigurisht përbën dhe thelbin e këtij vendimi, kërkon kryerjen e një analize të kujdesshme, me qëllim arritjen e përfundimeve dhe të konkluzioneve kushtetuese. Për këtë arsye, shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese i të njëjtës çështje, ndërmjet palëve të njëjta në proces që përmban një pretendim të ri për antikushtetutshmëri, nuk përbën gjë të gjykuar.

Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i garantuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit.

Gjykata Kushtetuese vepron si ligjvënës negativ, pasi duke shfuqizuar një normë, vendimi i saj merr fuqi të përgjithshme si çdo ligj shfuqizues. Asnjë organ tjetër, me përjashtim të vetë Gjykatës Kushtetuese (dhe kjo lidhet me ndryshimin e praktikës, apo rishikimin e kushtetutës), nuk ka të drejtë të vërë në diskutim vendimet e saj dhe aq më tepër të mos pranojë t’i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t’i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Roli i Gjykatës Kushtetuese qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj.

Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese dhe ka të bëjë me autoritetin e këtij organi.

Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, gjë që buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur.

Qëndrimi i mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që nuk kanë pranuar të zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, përbën shkelje të Kushtetutës dhe krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale.

Në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjenden edhe interpretime të dispozitave kushtetuese, mbi bazën e të cilave ato kanë konkluduar se Gjykata Kushtetuese nuk mund të rrëzojë interpretimin kushtetues të bërë nga Gjykata e Lartë. Sipas nenit 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë: “Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe”. Në të vërtetë, kjo dispozitë kushtetuese e lë në diskrecionin e organeve shtetërore interpretimin e Kushtetutës dhe mënyrën e zbatimit të drejtpërdrejt të saj, por nuk i njeh atyre të drejtën e interpretimit përfundimtar, që tashmë ka gjetur zgjidhje në nenin 124 të saj.

Duke analizuar dhe shqyrtuar me mjaft kujdes vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese konkludon se interpretimi që ato kanë marrë përsipër t’i bëjnë dispozitave të Kushtetutës që lidhet me vendimet gjyqësore dhe sidomos me vendimet unifikuese, të cilat i konsiderojnë të përjashtuara nga kontrolli i kushtetutshmërisë së tyre, nuk është i drejtë dhe krijon rrezikun për zgjidhje antikushtetuese të çështjeve, objekt shqyrtimi prej saj.

Në jurisprudencën kushtetuese është e njohur tashmë kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, që si rrjedhojë e një rekursi individual, të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore, duke patur kompetencën t’i shfuqizojë këto për antikushtetutshmëri. Ky koncept doktrinar është pranuar edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 131, shkronja “f” parashikon të drejtën e Gjykatës Kushtetuese të “vendosë për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor...”. Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre.

Nga ky këndvështrim edhe vendimet për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore që bëjnë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke qenë vendime unike dhe detyruese vetëm për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk mund t’i shmangen kontrollit të kushtetutshmërisë së tyre nga Gjykata Kushtetuese.

Në çështjen që lidhet me vendimin nr.17, datë 17.04.2000, Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar kërkesën e individit për shkeljen e të drejtave themelore dhe ka arsyetuar në vendimin e saj se është shkelur një parim mjaft i rëndësishëm kushtetues, pra e drejta e mbrojtjes. Vetë pohimi që bën Gjykata Kushtetuese se në çështjen konkrete është shkelur një parim kushtetues do të thotë se është rrjedhojë e konstatimit dhe e një analize të kujdesshme të zërthimit të dispozitës kushtetuese që sanksionon të drejtën e mbrojtjes. Ky konkluzion i Gjykatës Kushtetuese, i nxjerrë mbi interpretimin që ajo i bën të drejtës së mbrojtjes në konceptin dhe frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen konkrete, për Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe për jurisprudencën kushtetuese, është një interpretim përfundimtar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, padrejtësisht arsyetojnë në vendimet e tyre, se Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të bëjë interpretim të ligjit dhe se vetëm ato kanë ekskluzivitetin e këtij interpretimi.

Gjykata Kushtetuese e çmon të domosdoshme të theksojë se interpretimi i ligjeve nuk është funksion kushtetues ekskluziv i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Kushtetuta, sipas nenit 141 pika 2, i njeh Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të drejtën të njësojnë apo ndryshojnë praktikën gjyqësore, e cila mund të ketë në bazë edhe interpretimin e ligjit që lidhet me çështjen konkrete, por jo të kryejnë në mënyrë ekskluzive interpretimin e ligjeve. Ekskluziviteti në interpretimin e ligjeve nuk i përket Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ky është një interpretim i gabuar që Kolegjet e Bashkuara i kanë bërë nenit 141, pika 2 të Kushtetutës. Interpretimi i ligjit është e drejtë e çdo organi që merret me zbatimin e tij. Gjykata e Lartë, si çdo organ tjetër sigurisht që nuk përjashtohet nga e drejta e interpretimit të ligjit, por ky interpretim që ajo kryen nuk është dhe nuk mund të jetë përfundimtar dhe, sipas Kushtetutës, nuk ka fuqi detyruese të përgjithshme. Kushtetutshmërinë e këtij interpretimi në vendimin gjyqësor konkret, kur lidhet me të drejtat themelore të shtetasve në aspektin e procesit të rregullt ligjor, e kontrollon vetëm Gjykata Kushtetuese. Arsyetimi që do të përdorë në këtë rast Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj do të konsiderohet përfundimtar.

Objekti i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk ka qenë interpretim i ligjit, por gjykimi i ankesës së individit për një proces të rregullt ligjor. Detyrë kryesore e Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 124 të Kushtetutës është interpretimi përfundimtar i saj. Por, nëse në çështjen konkrete, Gjykata Kushtetuese që shqyrton kërkesën e individit konkludon se “mbrojtësi i të pandehurit që gjykohet në mungesë i caktuar sipas kërkesave të ligjit gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë edhe të drejtën e ankimit...”, - kjo nuk do të thotë se është bërë një interpretim i thjeshtë i ligjit, por është arritur, që të rikonfirmohet, nëpërmjet interpretimit kushtetues, një parim thelbësor që përbën garanci kushtetuese. Interpretimi i ligjit nuk duhet kuptuar thjeshtë si njohje aparente e një dispozite konkrete, por në thelb ai përbën vlerësimin e kuptimeve të ndryshme që norma juridike merr, kur ajo do të zbatohet, për të konkluduar në arritjen e një kuptimi të vetëm dhe në përputhje me Kushtetutën.

Përderisa Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe ushtron kontrollin kushtetues të normës juridike, asaj nuk mund t'i ndalohej të bëjë interpretim të ligjeve. Gjykata Kushtetuese shqyrton pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe me qëllim që të arrijë në një konkluzion përfundimtar për kushtetutshmërinë e tij është e qartë se ligjit konkret i duhet dhënë një kuptim, duke u interpretuar në të gjitha aspektet, si literal, gjyqësor, doktrinar, gramatikor, logjik, sistematik, historik, në interpretim të gjerë apo të ngushtë etj. Pikërisht, interpretimi që i bëhet ligjit në funksion të parimeve kushtetuese përbën juridiksion kushtetues dhe merr vlerën e një interpretimi përfundimtar dhe të detyrueshëm për të gjithë. Në këtë drejtim vendimi i Gjykatës Kushtetuese bëhet i detyrueshëm edhe për Gjykatën e Lartë. Prandaj jurisprudencë kushtetuese përbën çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese, aq më tepër shqyrtimi i rastit konkret që lidhet me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe konkretisht me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, duke e analizuar problemin nga ky këndvështrim, si dhe duke ju referuar koncepteve kushtetuese mbi funksionet dhe kufijtë e pushteteve të secilit organ, konkludon se me vendimet që ajo merr nuk shman asnjë organ kushtetues në ushtrimin normal të kompetencave, aq më tepër Gjykatën e Lartë.

Nisur nga argumentat e parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke mos zbatuar vendimin nr.17, datë 17.04.2000, kanë shkelur Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shkelje e cila në çështjen konkrete ka ndikuar drejtpërdrejt në mohimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtës për gjykim, duke mos i garantuar individëve të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

PER KETO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 72 e 77 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.371, datë 27.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar rekursin e prokurorit të ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.2.2001
Nr. 89/2 i Regj.Themeltar.
Nr.5 i Vendimit

VENDIM “NE EMER TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 25.01.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.101/5 Akti që i përket:

K E R K U E S: XHAVIT VULKU, i përfaqësuar nga avokati Ilir Selenica.

O B J E K T I

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve penale nr.97, datë 02.04.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.670, datë 01.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kërkuesi ka parashtuar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve penale nr.97, datë 2.4.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.670, datë 1.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë:

- Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e prokurorit pa i komunikuar kopjen e ankimit dhe pa i njoftuar datën e gjykimit. Si rrjedhojë, ai nuk ka ditur për gjykimin e çështjes në apel.

- Procesverbali i gjykimit në apel nuk pasqyron të vërtetën në pjesën që thekson, se i pandehuri është thirrur për gjyq. Në të vërtetë, është njoftuar drejtorja e burgut, por pasi ai kishte mbaruar dënimin e dhënë nga gjykata e rrethit.

- Gjykata e rrethit, në rigjykim, nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e gjyqit sipas rregullave të nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale e si rrjedhojë, nuk ka marrë dijeni për gjyqin as ai, as familjarët.

- Për të dy gjykimet e mësipërme nuk janë njoftuar as avokatët e tij, të caktuar qysh në fazën e hetimeve paraprake. Për më tepër, në Gjykatën e Apelit, gjykimi është bërë pa caktuar avokat kryesisht.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin Kujtim Puto, pretendimet e avokatit të kërkuesit, shqyrtoi dokumentet e ndodhura në dosjen gjyqësore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.111, datë 25.02.1999, ka dënuar kërkuesin Xhavit Vulku për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit dhe në bazë të nenit 114 të Kodit Penal, në lidhje me nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale (gjykimi i shkurtuar) e ka dënuar me gjashtë muaj burgim. Mbi ankimin e prokurorit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.97, datë 2.4.2000, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit e dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë. Kjo e fundit, në rigjykim, e ka dënuar me dhjetë vjet burgim për krimin e shtytjes për prostitucion në rrethana rënduese sipas nenit 114/a, pika 5 të Kodit Penal.

Gjykata e apelit dhe gjykata e rrethit, në rigjykim, kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës. Në radhë të parë, gjykimet janë zhvilluar pa njoftuar të pandehurin ose avokatët e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Kështu, ndërsa prokuroria ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr.111, datë 25.2.1999 të gjykatës së rrethit, kopja e këtij ankimi, nuk i është dërguar kërkuesit sipas mënyrës dhe në vendin e parashikuar në nenin 140 të Kodit të Procedurës Penale për të pandehurin e lirë. Kjo kopje, së bashku me lajmërim-marrjen është dërguar në repartin 311 (burg) në datën 4.3.1999, kur i pandehuri kishte mbaruar dy ditë më parë dënimin e dhënë nga gjykata e rrethit e ndodhej në gjendje të lirë. Ndodhur para këtij fakti, Gjykata e apelit nuk mund të vazhdonte gjykimin, por të kërkonte zbatimin e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale për t'i njoftuar ankimin të pandehurit.

Në procesverbalin e seancës gjyqësore datë 2.4.1999 në Gjykatën e apelit, pasqyrohet sikur është thirrur për gjykim edhe kërkuesi, por në të vërtetë nuk ka njoftim për të. Në dosje ndodhen dy shkresa me të njëjtin numër 19 dhe me të njëjtën datë 16.03.1999, drejtuar njëra komandës së Repartit 313 (burgut) e tjetra togës së shoqërimit, në të cilat kërkohet të shoqërohet i pandehuri në atë gjykatë. Duke marrë parasysh se i pandehuri është liruar nga burgu në datën 02.03.1999, pra 14 ditë më parë se të nisen shkresat dhe se në dosje nuk ka njoftim tjetër për të pandehurin, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin, se gjykimi i çështjes në atë gjykatë është bërë pa njoftuar të pandehurin.

Njoftimi i të pandehurit sipas Kodit të Procedurës Penale, nuk është bërë as në rigjykim në gjykatën e rrethit, aq më tepër, që nga kjo gjykatë u dënua për një vepër penale shumë më të rëndë se e mëparshmeja. Për datën 15.7.1999 (dita kur u zhvillua seanca e parë e gjykimit), i është dërguar një shkresë togës së shoqërimit, me të cilën i kërkohet të shoqërojë në gjykatë të pandehurin Xhavit Vulku, me banim në Fshatin Tapizë, Tiranë dhe një polic i togës së shoqërimit ka shënuar në të që i pandehuri ndodhet në Greqi, por nuk del nëse është njoftuar familja, fqinjët, avokatët e caktuar prej tij etj., sipas mënyrës e në vendet e parashikuara në nenin 140 të Kodit të Procedurës Penale. Jo vetëm kaq, por meqënëse njoftimi ishte i dyshimtë, gjykata, në zbatim të nenit 349 të Kodit të Procedurës Penale, duhet ta përsëriste atë përpara se të deklaronte mungesën e të caktonte mbrojtës kryesisht.

Duke mos u njoftuar kërkuesi për ankimin e prokurorit, si dhe për datën e gjykimit në apel e në gjykatën e rrethit, atij i janë mohuar njëkohësisht disa të drejta kushtetuese të parashikuara edhe në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, siç janë e drejta për ta vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet (neni 31/a i Kushtetutës dhe neni 6/3a i Konventës), e drejta për t'u mbrojtur vetë e për t'u bërë pyetje dëshmitarëve të pranishëm apo e drejta për të kërkuar marrjen e provave të tjera (neni 31/b,c të Kushtetutës dhe neni 6/3c,d i Konventës), si edhe e drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet (neni 33 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës).

E drejta e të pandehurit për të zgjedhur mbrojtësin e tij është njëkohësisht edhe një detyrim për gjykatën për ta respektuar këtë të drejtë.

Eshtë e vërtetë që gjykata e rrethit në rigjykim ka caktuar mbrojtës dhe i ka dhënë kohë atij të përgatitet, por kjo nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin, se gjykata ka përmbushur detyrimet e saj kushtetuese e ligjore për realizimin e së drejtës së mbrojtjes. Eshtë detyrë e gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit të kryejnë të gjitha veprimet procedurale për njoftimin e të pandehurit, dhe vetëm kur ky nuk paraqitet, të caktojnë mbrojtës kryesisht. Për më tepër, gjykata e apelit nuk ka caktuar as mbrojtës kryesisht, por ka dëgjuar vetëm prokurorin, duke mos respektuar parimet e rëndësishme të mbrojtjes dhe të kontradiktoritetit në gjykim.

Të gjitha këto e bëjnë procesin të parregullt në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës.

PER KETO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f të Kushtetutës dhe në neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve penale nr.97, datë 02.04.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.670, datë 1.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 22.2.2001

Nr. 101/5 i Regj.Themeltar.

Nr. 9 i Vendimit.

VENDIM

Nr. 37, datë 12.2.2001

**PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN LOKAL PRIVAT
“TV KURBINI”**

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “KTV 1” sh.a.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit shoqërisë “KTV 1” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Deri në datën 31.07.2001, transmetimi televiziv tokësor i subjektit, të kalojë në brezin UHF.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 40/1, datë 6.3.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TRIO CABLE TELEVISION”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “VËLLEZËRIT JAKUPI” sh.p.k

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit SHOQËRIA “VËLLEZËRIT JAKUPI” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve televizive me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen natyra e programeve, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 40/2, datë 6.3.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“ALFA”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ALFA” sh.p.k

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit SHOQËRIA “ALFA” sh.p.k. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve televizive me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen natyra e programeve, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 40/3, datë 6.3.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“AVN CABLE TELEVISION”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “AVN CABLE TELEVISION” sh.p.k

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit SHOQËRIA “AVN CABLE TELEVISION” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve televizive me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen natyra e programeve, që do të transmetohen, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 40/4, datë 6.3.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TV BUTRINTI”

SUBJEKTIT: Z. TEFIK AVDULLAI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit Z. TEFIK AVDULLAI licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve televizive me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen natyra e programeve, që do të transmetohen, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr. 40/5, datë 6.3.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“TV IRLA”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “IRLA “SH.P.K

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit SHOQËRIA “IRLA” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve televizive me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen natyra e programeve, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR
TË RADIO-TELEVISIONIT SHQIPTAR
Sefedin Çela

VENDIM
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesën e Lumnije Bishës, me vendimin nr.788, 17.8.2000 shpall të zhdukur shtetasin Dashamir Muçllari.

VENDIM
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesën e Dhurata Recaj, me vendimin nr.71, datë 15.1.2001 shpalli të zhdukur shtetasin Mehmet Recaj.

KËRKESË
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Kërkuese: Majlinda Topuzi, e bija e Menduhit dhe Nexhmies, lindur dhe banues në Trepçë, e martuar me një fëmijë.

Objekti: Shpalljen e zhdukjes së bashkëshortit tim Urim Topuzi, në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë, kërkuesja Majlinda Topuzi, kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti im, Urim Topuzi. Në 9 mars 1996 u nis me motoskaf në Itali. Nga data e nisjes kanë kaluar shumë vite dhe unë nuk kam asnjë informacion për vendndodhjen e tij. Sa më sipër kërkoj nga gjykata të shpallet i zhdukur bashkëshorti im, Urim Topuzi.

KËRKUESI
Majlinda Topuzi

KËRKESË
(PËR SHPALLJE TË VDEKUR)

Kërkues: Luigj Toma, i biri i Nikës, lindur në Krujë dhe banues në Fier, i martuar, me fëmijë.

Objekti: Deklarimin të vdekur të bashkëshortes Magdalena Sami Toma në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesi Luigj Toma, kërkoj të shpallet e vdekur bashkëshortja ime, Magdalena Toma. Në 27 janar 1997 ajo u nis me gomone së bashku me dy kushërinjtë e mi për në Itali. Me vendim nr.1061, datë 13.9.1999 të Gjykatës Fier është vendosur shpallja e zhdukur që nga dita e ndodhjes së tragjedisë të bashkëshortes sime. Në këto kushte, meqë kanë kaluar 4 vjet nga dita e shpalljes të zhdukur, kërkoj që bashkëshortja ime Magdalena Toma të shpallet e vdekur.

KËRKUESI
Luigj Toma

KËRKESË
(PËR SHPALLJE TË VDEKUR)

Kërkuesi: Peme Shipe, e bija e Qamilit dhe Nasikës lindur në Panarit dhe banues në Qafzez të Kolonjës.

Objekti: Shpalljen të vdekur të Rakip Shipe, në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë, kërkuesja Peme Shipe, kërkoj të shpallet i vdekur djali im Rakip Shipe.

Në 15 gusht 1994 ai është larguar për në Greqi si emigrant. Meqë kanë kaluar 6 vjet dhe nuk kam asnjë njoftin prej tij, kërkoj nga gjykata të shpallet i vdekur djali im Rakip Shipe.

KËRKUESI
Peme Shipe

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 30.3.2001
Doli nga shtypi më 2.4.2001

Tirazhi: 4200 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi 150 lekë